

*Lulëzime Celami*



*Jetë në kthim*

Roman

LULËZIME CELAMI (ÇIPOLLARI)

# Jetë në kthim

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2012

Botuese: Irena Toçi

Redaktorë letrarë: Ndue Dedaj, Bardhyl Xhama  
Korrektore letrare: Nertila Ali  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 - 99943 - 1 - 000 - 0

© Autorja

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 4 22 58 893

Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: [toena@toena.com.al](mailto:toena@toena.com.al)

[redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

**T**ë tre po i ngjiteshin të menduar të përpjetës.  
Rruga me gurë i detyronte të ecnin ngadalë.  
Epo një rrugë e tillë në një lagje qyteti! Absurditet! -  
foli Meri duke u mbajtur pas Elit.

- Nuk e dija, se do të kisha veshur këpucët e sheshta.

Sa më shumë ngjiteshin, aq më shumë rralloheshin shtëpitë. Ndjesia se po bënë vizitë në një fshat malor forcohej te të dyja. Ndërtesat e mbira nga shpati i malit i qëndronin besnike një renditjeje të caktuar. Shumica të porsandërtuara me të njëjtin stil. Shtëpi njëkatëshe me mure të pasuvatuara, dritare më të vogla se ato të apartamenteve dhe me një pjesë oborri përpara. Nga sistemimi i oborreve të shtëpive mund të krijoje një përshtypje për gjendjen e njerëzve që banonin aty.

Diku lule dekorative të mëdha, tavolinë me karrige të vendosura në mes ose në cep të oborrit dhe një

rrethim me mur të bardhë jo të lartë. Qëllimisht muri do të ishte me atë lartësi, për të vendosur kontakt me shtëpitë aty pranë.

Më shumë mbizotëronin oborret e pasistemuara.

Era e bërsisë së rakisë i ngacmoi të tre. Vetëm pak metra më tutje rruga ishte shtruar me bërsi, sikur kishin dashur të zëvendësonin asfaltin e munguar.

Fushata e punëve të stinës, përhapte një ndjesi të veçantë. Gjithçka rreth e rrotull mbante mbi vete një mision për të kryer. Ajri, ai më i rëndësishmi. Shpërndante kudo aromat dhe zhurmat e kësaj stine. Dikujt, ia përplaste me forcë në fytyrë, duke i kujtuar se koha ecte. Bashkë me të lëvrinte kudo lozonjar dhe ai vetë.

- Ja, kjo është shtëpia e Silvës, - foli Eli duke i shkëputur nga mendimet.

- Mirëdita! - përshëndetën në oborr një mesogrua, me flokë të kapura nxitimthi pas kokës, e cila po i shihte me mëdyshje.

- Unë jam drejtoresha e shkollës së Silvës dhe Merin besoj se e njihni, pasi është mësuesja kujdestare e saj, - u prezantua drejtoresha duke dashur të mbyste ato hije dyshimi që mbizotëruan në ato pak çaste.

- Oh, urdhëroni brenda, - ngurroi gruaja e hutuar nga kjo vizitë e papritur. Pantallonat e përveshura deri në gju, plotësonin pamjen e atij peizazhi vjeshte.

- Jo, jo, nuk kemi kohë. Kemi ardhur për Silvën, pasi ka plot një muaj që nuk vjen në shkollë.

- Eli na tha se Silva nuk do të vazhdojë më shkollën. Nervozizmi te fjalët e mësuese Merit tërhoqi shikimin e të gjithëve.

Ai qëndronte në cep të oborrit dhe mbante kokën ulur. Ngjyra e kuqe e fytyrës tregonte dukshëm se në ato çaste nuk ndihej mirë. Mendimi se kishte treguar të vërtetën në shkollë për Silvën i jepte kënaqësi, sepse s'mund të ndjehej i qetë për atë që po i bënin prindërit asaj. Por, nga ana tjetër, kishte tradhtuar besimin e dajës (babai i Silvës ishte daja iELIT), dhe kjo e bënte të mos ndihej rehat. "Të paktën daja nuk është këtu tani!", mendoi.

- Ah, Eli! Është djali i kunatës, - mermëriti mami i Silvës duke iu shmangur përgjigjes së pyetjes.

- E vërtetë është kjo? - toni i prerë i drejtoreshës i përshkoi trupin. Kurrë nuk kishte menduar se mund të gjendej në një situatë të tillë.

- Po, po. Im shoq nuk do ta lërë. Ka frikë. Ajo është rritur tashmë dhe është zhvilluar. Në zërin e nënës së Silvës lexohej qartë dhembja dhe protesta për vendimin e të shoqit.

- Po Silvën? E keni pyetur se ç'dëshiron ajo?

Nota dhimbjeje ndiheshin tashmë në zërin e drejtoreshës. Vetëm duke parë atë grua do të kuptoje se brenda saj kishte pak forcë, shumë pak forcë.

- Ku është Silva? Do të donim ta përshëndetnim,  
- malli dhe dashuria lexoheshin qartë në fjalët e mësuese Merit. Nuk mund të mos e vinte re këtë gjë dhe ajo grua e ndrojtur, e bindur për të pranuar

qorrizi vendimet e të shoqit. Kërkonte me çdo kusht qetësinë familjare. Largimi i Silvës nga shkolla, qe çmimi i kësaj qetësie. Autoriteti i të shoqit nuk mund të diskutohej në këtë shtëpi. Edhe pse në këto çaste s'ishte i pranishëm fizikisht, autoriteti i tij endej mbi hapësirën e kësaj familjeje. Ai ishte aty. Në çdo çast.

\* \* \*

Kënaqësisë së rritjes dhe zhvillimit të saj, ashtu si të çdo moshatareje, kur trupi fillon të harkohet e syri shëtit ëndshëm mbi linjat e sapoformuara, i kundërvihej me një shikim tepër të rreptë dhe zë të ashpër babai. Asnjëherë nuk e kuptoi rreptësinë e shikimit dhe vrazhdësinë e zërit të tij. Rrinte me orë të tëra duke u menduar për të gjetur shkakun e zemërimit të të atit. Por asgjë.

Një ditë, kur po i gëzohej fustanit të ri përpara pasqyrës, kuptoi më në fund mllëfin ndaj saj.

“Si është e mundur?!” Lot dëshpërimi e mbuluan të gjithën dhe fjalët i ngecën në grykë. “Si është e mundur?!” Kjo pyetje nuk i shqitej nga mendja. Çdo prind nga dashuria për fëmijën e tij, duhet t'i kënaqet zhvillimit. E kush do të donte një fëmijë të pazhvilluar?!

Ndërsa me babanë po ndodhte ndryshe. Ndryshimet në trupin e saj do të shoqëroheshin me shikimet e rrepta nga ai. Mos duhej të mbetej e vogël

për të gëzuar përkëdheljet dhe dashurinë atërore?! Por jo çdo gjë mund ta vendoste vetë. Zemërimi arriti deri në momentin kur një mëngjes i tha së shoqes.

- Silva nuk do të shkojë më në shkollë.

- Çfarë?!

- S'do të shkojë më në shkollë! Apo nuk e sheh se ç'bëhet?

- Si do ta lëmë vajzën pa shkollë?

- Mojl! Je në vete? Nuk e sheh si është zhvilluar jot bijë? Është bërë grua. Apo mos do të ta rrëmbejnë në rrugë? Sheh televizor ti, apo jo?!

- Nuk të rrëmben kush po i pate mendtë në vend!

- Posi mojl, posi. Merr vesh ti se ç'bëhet, kur rri gjithë ditën në shtëpi.

- Po, pastaj ajo rrugën e bën me Elin. S'thuhet shqyr që janë bashkë?

- Vajza të mos e kapërcejë më pragun e derës sonë. Kaq po të them unë. Më mirë pa shkollë e me faqe të bardhë se, të përfundojë në rrugë të madhe! – dhe përplasja e fortë e derës, nuk shkaktoi më shumë dridhje se fjalët e tij në zemrën e Silvës, që i dëgjoji nga korridori.

Qysh atë ditë zemra e saj ishte e ngrirë. Në trup i lëvizte vetëm gjak i ftohtë. Nuk kishte më ngrohtësi. As në lëvizjet e saj. Flladi mëngjesor s'arrinte t'i lante as fytyrën dhe as ëndrrat. Ai fllad ishte larguar. Rrezet e para të mëngjesit që i binin mbi shtrat. i dukeshin se binin thjesht për t'u tallur me të dhe për ta torturuar më tej.



Dhe në mendje, me gjithë këtë angështi që e pushtoi menjëherë, endej pambarimisht pyetja “Përse?”. Nuk mund të gjente përgjigje tjetër përveçse fjalës ngujim.

Tashmë u ngujua në shtëpinë e saj. Jo nga gjakmarrja, por nga zhvillimi.

Ç’paradoks!

Çdo mëngjes për të vinte i trishtuar. Nga cepi i dritares ndiqte me sy Elin, kur nisej për në shkollë derisa humbiste në cepin e rrugës dhe atëherë loti i pabindur rrëshqiste nëpër faqe, duke i larë pa dëshirën e saj fytyrën. Në vend të përkëdheljes së flladit mëngjesor, i binin dhunshëm lotët e kripur. Nuk gjente forcë tjetër. Duhej të pranonte fatin e saj. Kështu që e thënë.

Ndërsa në këto çaste, tek ndiqte nga cepi i dritares bisedën që po bëhej me nënën, diçka e ngrohtë i lëvizte nëpër trup. Nuk e kuptonte as vetë, nëse duhej të mërzhitej nga vizita e mësueses dhe e drejtoreshës, apo të gëzohej se po ndizej një dritë shprese. Ndoshta!

- Silva! Eja pak.

U drodh. Zëri i lodhur i nënës ia shtoi të dridhurat si me komandë. Duhej t’u dilte përpara! Po si? Mos vallë ajo vetë vinte nga parahistoria? Nuk arrinte ta besonte! Admirimi i klasës për të nga përgjigjet në mësimet e struktur diku, po i dilte përpara i shpërfytyruar. Po tallej. Supet po i rëndonin. Fytyra i përvëlonte. Lotët rrëshqitën pa e pyetur për ta bërë më qesharake. I fshiu me duart që i dridheshin dhe

doli në oborr. Vetëm uli kokën. U ndodh përballë tyre. Sa turp! Sot kur të gjithë vraponin si të çmendur pas shkollës, ajo ishte nënshtruar pa kundërshtuar fare, pa bërë përpjekjen më të vogël. I vinte turp nga vetja. Përse kaq shpejt duhej të dorëzohej përpara vështirësive?! Qysh në pengesën e parë?! Po jeta është e gjatë. Vështirësi do të ndeshte gjithnjë e më shumë. Dhe ajo çfarë do të bënte. Do të ndalej?! Do të rrinte aty ku e detyronin të mbetej?!

Çudi! Të gjitha këto mendime po i lëviznin vullshëm. Tani, përpara mësueses së saj. Ndoshta ndikimi i veçantë i mësuese Merit që më tepër se thjesht i një mësueseje. Vetëm prania e saj aty bëri të lëviznin mendime, që për shumë kohë qenë struktur, kushedi se ku.

- Më ka marrë malli Silva! Tërë këtë kohë me besimin se në mëngjes do të shfaqeshe mes nxënësve. Të gjithë i ka marrë malli për ty, “ fjalët e mësueses u binin më tej akordeve të zemrës. Ndjeu brenda vetes një muzikë të ëmbël. Nuk foli. Por kjo muzikë ngacmoi lotët e struktur për disa sekonda. Ata s’arritën të rrinin më aty. Vazhduan rrugën e tyre.

- Nuk kemi ç’të bëjmë. Çdo natë i lutem për vajzën, por ai s’pranon. Ka frikë. E ruan si një lule të shenjtë.

- Dhe lulja po ndenji mbyllur pa ajër, vyshket. Por, ne jse, do të donim ta takonim. Kur mund ta gjejmë? – toni i drejtoreshës ndryshoi ngjyrë. E si mos të ndryshonte përballë atyre lotëve që rridhnin rrëke dhe ndrydhjes së asaj gruaje?!

- Është në punë, larg. Mund të të jap numrin e telefonit.

Askush nuk fliste gjatë kthimit. Mendimet qenë ngrirë duke formuar ajsbergë të tërë. Këto ajsbergë lodronin në një oqean të madh lotësh me emrin “Oqean pafajësie”.

Te Meri, ky ajsberg zinte vendin më të madh.

\* \* \*

Me fustanin e bardhë pas trupit, ku disa lule të vogla të kuqe lodronin me endje mbi të, dhe një çantë të vogël në dorë, qëndronte në cep të rrugës dhe ndiqte me sy babin e saj. Ai priste i shqetësuar për ndonjë makinë. Pranë, si shoqëruese e heshtur, një valixhe dërrase me ngjyrë bizele, e kyçur me një dry të vogël. Një buzëqeshje i rrëshqiti në buzë. Kushedi sa qenë lodhur për të sajuar një valixhe të tillë. Dhe ajo do të ishte bashkudhëtarja më besnike në të katër vitet e shkollës, pasi në shkollë të lartë nuk do të pranonte më ta merrte me vete.

Pastaj, se mos ajo valixhe përfaqësonte vetëm ato dy copa dërrasash të puthitura bashkë me kyç! Ajo mbante brenda muaj të tërë përgatitjesh për një jetë të re. Ruante me kujdes porosinë e nënës, shqetësimet për të panjohurën që e priste. Brenda, të palosura bukur, fustane, xhupa, të brendshme, furçën e dhëmbëve dhe plot sende të tjera. Në çastin kur nëna i futi tërë ato garza të prera në të njëjtën

madhësi dhe të hekurosura me kujdes, e pyeti me habi:

- Po pse tërë këto garza! - I bëri përshtypje buzëqeshja e nënës. Kuptoi se donte t'i tregonte diçka, por u mjaftua vetëm me kaq.

- Do të të duhen shpirt!

Nuk pyeti më tej. E dinte se kur nëna vendoste të thoshte aq, nuk do të fliste më. Por gjatë gjithë kohës nuk reshti së porosituri:

- Kujdes bija ime! Je larg meje. Duhet të jesh e kujdesshme në çdo hap!

- Të lutem mami, ndihem keq kur më jep kaq shumë porosi! Duket sikur ti nuk ke besim tek unë!

- Jo moj shpirt! E si nuk paskam besim! Tjetër është besimi e tjetër janë rrethanat në të cilat ndodhesh. Duhet të jesh e kujdesshme.

- Po pse, moj mami, në luftë po shkoj unë?

- Ah, zemër! Po jeta luftë është! Po ku mund ta kuptosh ti këtë! Je ende e re! Lufta s'bëhet vetëm me armë, shpirti im, por dhe me mendje. Po e pate mendjen në vend, nuk humbet, je fitimtare. Ecën drejt, pa drojë dhe i ke dyert e hapura. Por, po gabove njëherë, asgjë s'rregullohet.

Ndjeu një sëmbim në shpirt kur kujtoi fjalët e nënës. Jo se i kuptoi mirë të gjitha ato që i tha, por gjithsesi e ndiente që fjalët qenë të përziera me mjaltë për të vetmen arsye. Ajo ishte gjëja më e shtrenjtë për të. Në çdo fjalë ndiente përkëdheljet, të cilat nëna nuk harronte t'i shoqëronte dhe me "shpirt", "zemër".

Ndërkohë, Meri ndihej e mbrojtur nën këto përkëdhelje.

Nuk i vinte mirë kur dëgjonte ndonjë tek i thoshte mamit. “Do ta marrësh në qafë tët bijë me tërë këto ledhatime!”

Në anën tjetër, Meri adhuronte dhe të atin. Ndiante shqetësim për këtë largim në çdo lëvizje dhe sidomos në sytë e tij.

- Eja Meri, – e shkëputi zëri i të atit nga tërë ato kujtime të freskëta. Babai rrëmbeu valixhen dhe të dy hipën në një makinë. Për Merin do të niste një jetë e re.

Më pas ankthi për sistemimin në konvikt dhe zëri i babait në fund kur po ndahej.

- Kjo është rruga jote tashmë. Ëndrra për t’u bërë mësuese. E di se do të krenohem gjithnjë me ty! Pastaj puthja e tij në faqe dhe përkëdhelja e flokëve do të rrinin me ditë të tëra aty, për t’i kujtuar në çdo çast se, jo shumë larg, kishte një dashuri të pazëvendësueshme, më të madhen, atë prindëroren.

Një drithërimë e lehtë i përshkoi trupin. Ndo dhej në një ndërtesë të vjetër, në një dhomë me shtretër hekuri dykatësh, ku do të flinin plot tridhjetë vajza të ardhura nga rrethe të ndryshme. Ajo që nuk kishte kaluar një natë të vetme larg shtëpisë! Ndiante pasiguri. Dalëngadalë dhoma u mbush me vajza të ardhura nga larg, të cilat Meri i shihte me dyshim. Vetëm dy vajza ishin nga qyteti. Të gjitha të tjerat nga fshatrat. Me kokën e mbuluar me jastëk, ndenji kushedi sa, për të shmangur gjurmët e shqetësuar të prezantimit të parë me shoqet e dhomës. I dukeshin

ndryshe në fytyrë, në mënyrën e veshjes dhe në të folur, ku secila sillte të folmen e zonës nga vinte. Si mund të bashkëjetonte me to?!

Për një çast iu kujtua fjala e nënës. “Jeta është luftë!”. Do t’i duhej të bashkëjetonte me njëzetënëntë vajza me mendime krejt të ndryshme nga ajo, zakone të tjera, mënyrë sjelljeje, të foluri apo dhe të ecuri ndryshe. Mendimi se fshati ndryshonte nga qyteti në çdo këndvështrim e bënte të ndihej keq, prandaj në fillim u miqësua më shumë me Sonjën që ishte nga Saranda.

Zëri i kujdestares shponte si turjelë tejpertej murin çdo mëngjes.

- Hajdeni vajza, zgjohuni! “ Ky qe refreni mëngjesor.

Mësimin e zhvillonin në katin e parë të konviktit. (Konvikti i tyre qe një ndërtesë e vjetër, që dikur kishte qenë shkollë priftërinjsh). Kohën e lirë pas studimit e kalonin duke luajtur, e gjithë klasa bashkë. Tashmë ishin bërë një familje e madhe, që kujdeseshin për njëri-tjetrin pa asnjë djallëzi, por me dashuri vëllazërore. Shpesh me ta luante dhe kujdestar Femiu, një njeri i dashur për të gjithë.

Vetëm një herë në muaj shkonte në shtëpi. Ankthi i fillimit të kësaj jete dalëngadalë u zëvendësua me mallin për familjen dhe vetësigurinë se mund të jetonte dhe larg saj. I kujtohej mjaft mirë kur një herë i lutej babait në shtëpi:

- Të lutem babi, eja në shkollë dhe tako mësuesin kujdestar.

- Përse? Mos ke ndonjë problem? – dhe shqetësimi u lexua menjëherë në timbrin e zërit të tij.

- Absolutisht, jo. Por, nuk e di, duhet të të shohin dhe të tjerët se ju vini të pyesni. Ndihem keq kur i shoh prindërit e shoqeve të mia të vijnë aq shpesh.

Shikimi i tij i thellë u ul këmbëkryq mbi mua.

- Si mendon ti, se ardhja dhe ndenjja pas porte si roje, shton interesimin tonë për ty?

- Jo, por..., “ nuk dija se ç’të thosha.

- Ne, deri në çastin kur të nisëm për në shkollë, jemi kujdesur për ty që ti të jesh e zonja e vetes. Atë ditë, ne ishim të bindur që do të ecje pa mëdyshje, frikë apo pasiguri. Pastaj, pastaj ti e di se sytë e mi janë kudo ku je ti. Në çastin kur mund të kesh probleme, do të na tregosh vetë. Është shumë më mirë sesa kur problemet e tua t’i marrim vesh nga të tjerët. Apo jo?

Qeshë mikluar shumë nga fjalët e babit. Nuk e di, por me besimin i tij më dha më tepër siguri. Unë isha e zonja e vetes!

- Meri, patjetër që duhet të bisedojmë me babain e Silvës! - e shkëputi drejtoresha nga mendimet.

- Po, po, duhet, - vetëm sa përforcoi Meri.

Atë ditë, në mendjen e Merit do të endeshin kujtimet e një kohe të shkuar. Ato qenë fshehur ndokund, pa pasur mundësinë për t’i shfletuar. Vizita në shtëpinë e Silvës i hapi këto fragmente të jetës së saj. Fragmente të brishta! Gjithsesi, ato qenë aty.

Ai e priste në lokalin e ri të saponjërtuar. Shpesh ky lokal i bënte përshtypje për fasadën e jashtme tepër të veçantë. Dukej gjithandej i veshur me ngjyrën gri, me nuanca të kuqe dhe po të afroheshe më pranë, brenda këtyre ngjyrave thureshin dekorime të ndryshme. Duhej kohë për t'i deshifruar këto dekorime. Hapat u bënë më të pasigurta kur në rrugë u përshëndet me mësuese Merin.

- Nga mbiu dhe kjo! - i kaloi vetëtimthi në kokë. Por mësuese Meri nuk i kushtoi vëmendje. Vetëm sa e përshëndeti dhe vazhdoi rrugën duke folur me djalin e saj e vogël.

Hyri brenda në lokal me dyshimin që e shoqëronte në çdo çast. Ndoshta më mirë të mos vinte. Fundja si mund të takonte një të panjohur? Por mendimi se duhej të njihje njerëz të rinj, fitoi. Ndiante nevojën për shoqëri të re. E tërhiqnin pas vetes surprizat dhe të rejtat sa do të donte të shoqërohej në çdo moment me to.

Ndjeu rrahjet e zemrës t'i shpeshtoheshin dhe gati-gati donte të kthehej mbrapsht.

“Përse i ishte bindur qorrazi ftesës së tij?” Ajo s’e njihje ende mirë atë. Por diçka si magnet e tërhiqte, ndoshta vështrimi apo mënyra se si fliste ai. Ja, e pa se si u ngrit dhe gjithë mirësjellje e ftoi të ulej.

- Për pak më bëre të mendoj se nuk do të vije. Zëri i tij zbriti dhe u ul në zemrën e saj, për të qetësuar rrahjet e për të harmonizuar lëvizjet e gjoksit. – Sikur



të mos vije, do të më bëje të shkoja të zëvendësoja ndonjë roje nate, se nuk do të më zinte gjumi.

Grejsa nuk foli. Shikonte lëvizjet e buzëve dhe i dukej sikur po shikonte buzët më të bukura në botë. Nuk e kishte mendjen aq shumë te fjalët që po i thoshte, vetëm si e përhumbur i foli:

- Përse më thirre?! Në të vërtetë s'doja të vija, por në çastin e fundit vendosa...

- Shumë mirë bëre, - nuk e la të mbaronte fjalën, - dhe do ta kuptosh se nuk do të bëhesh pishman.

Ç'po ndodhte me të kështu? Ç'ishte ky zë, ky shikim i munguar me kaq ndikim mbi të?

- Ç'do të merrni? “ zëri i kamerierit që nxitonte të merrte porosinë, shkëputi çuçurimat ledhatuese të qelizave të saj. Ai nuk ngurroi të shoqëronte me një vështrim hetues Grejsën.

- Akulllore me të gjitha shijet për zonjushën dhe për mua një birrë Moreti, - nxitoi të porosiste për të larguar kamerierin sa më shpejt.

- Me çfarë shijeje akulloren?

- Me të gjitha shijet, - i sigurt se kishte bërë porosinë e duhur për Grejsën. – Patjetër që akullorja të pëlqen, – përforcoi vendimin e tij në zgjedhjen e bërë.

- Po ku e di ti, – nuk iu durua Grejsës pa e ngacmuar me zërin çapkën. Nuk arrinte të kuptonte se nga i doli ai zë në ato çaste.

- Unë di gjithçka për ty shpirt! – dyshimi në sytë e Grejsës për fjalën përkëdhelëse të porsa dëgjuar bëri të mos shkëputej ligjërata e nisur.

- Si shpirt më je! E pse s'duhet të të them kështu atëherë? Mos më bëj, se në këto çaste mund dhe të ulëri: "Shikojeni këtë shpirten këtu!". Pastaj çdo minutë të jetës tënde unë jam aty, me ty.

Ai vazhdoi përsëri.

- Nuk ke si ta kuptosh. Pasi për ty deri në këto momente e di se nuk kam ekzistuar. Por tani jam i bindur se do të jetë ndryshe për të dy. Kam plot një vit që të ndjek herë nga afër dhe herë nga larg. Kam jetuar me shqetësimet e tua, kam jetuar me frymëmarrjen tënde.

Asnjëherë nuk kishte dëgjuar fjalë kaq të bukura. Fjalët e flirteve të mëparshme "Je yll!" ... e kushedi sa të tjera, shembeshin aq rrëmbimthi duke u turpëruar për vobektësinë e tyre. Këto fjalë po e bënë të ndihej si kurrë ndonjëherë. Ngjyra e kuqe përshkoi vrullshëm fytyrën e shkoi deri te majat e veshëve. Rrahjet e zemrës po e tradhtonin. Ulje-ngritjet e gjoksit tërhiqnin shikimin e syve të tij. Ai shikim ngulej pa asnjë droje mbi të.

- Po unë s'të kam parë asnjëherë, - dhe ndërkohë luante me lugën e akullores sikur donte të fshihej në bardhësinë e saj.

- Mos u mërzhit shpirt! – dhe ndjeu dorën e tij mbi të sajën.

- Tani do të më shohësh më shpesh, pasi unë s'mund të rri pa puthur sytë e tu, qoftë dhe nga larg.

Grejsa largoi ngadalë dorën me pretekstin se do të hante akulloren. Do të donte të hynte brenda saj për

të shuar atë nxehtësi që e kishte pushtuar dhunshëm. Mendimi se këtë radhë me të vërtetë po binte brenda nuk po i shqitej për asnjë çast. I pëlqente ky djalë. Kushedi sa vjeç mund të ishte, por a nuk thonë se dashuria nuk njeh moshë dhe sa e sa raste dinte për diferencën e moshës në mes të dy të dashuruarve, që, gjithsesi, kanë bërë jetë të lumtur, kur dashuria ka qenë e pastër. Ajo nuk mund të kishte fatin e dashurisë së mamit të saj. S'mund të përsëritej e njëjta histori në të njëjtën familje. S'mund të jetohej i njëjti realitet dy herë. S'mund të ndodhë kurrë!...

I kujtohej mirë nata kur i braktisi babai.

Dhe pse 9-vjeçe, mbante mend fytyrën e hakërryer të babait kur i përplasi mamit celularin në mur. Çdo gjë i kujtohej si nëpër mjegull. Babai pati folur diçka për mesazhet dhe zilet e telefonit që i vinin kohë pa kohë. Grejsa atëherë nuk e kuptonte se ç'ishin mesazhet. Sa herë u përpoq të gjente përgjigjet e pyetjeve të pafundme se, përse babai nuk jetonte më me ta. Gjithsesi, tani edhe pse e rritur, mesazhet për të prapëseprapë do të mbeteshin tmerr. Asnjëherë nuk mori guximin të shkruante ndonjë mesazh, qoftë dhe urimi. Fytyra e zbardhur e mamit përcillte tmerrin e përjetuar. Ajo vetëm mërmëriste.

- Nuk është e vërtetë! Nuk është e vërtetë!

Megjithëse i ati shkonte t'i takonte shpesh dhe i ndihmonte me para, mungesa e tij bëri të ndryshonin shumë zakone në shtëpi. Grejsës i duhej

të kujdesej dhe për të motrën, pasi e ëma punonte me orar të zgjatur.

Shpesh kur dilnin bashkë, Grejsa bëhej xheloze për të ëmën, pasi shumë veta u thoshin:

“Shiko! Më e mirë e ëma se e bija!”

Në të vërtetë, si me të qeshur, mami një ditë i pohoi se kur ishin bashkë i dilnin lakrat sheshit, pasi rritja e Grejsës rrëfente moshën e saj.

Të dyja bashkë dukeshin më shumë si motra.

Nuk i erdhi mirë. Iu dukën çaste të dhimbshme. Ato e shoqëruan gjatë gjithë rrugës për në shtëpi. Përse duhej t’ia prishnin një ditë aq të bukur? Duhej t’i harronte për të ndenjur me shijen e atyre çasteve magjike të dhuruara nga ai.

Por, mendja e pabindur vazhdonte të shëtiste në të dyja kahet e kundërta të saj. Te çastet e sapo shijuara dhe dhembja e shumë viteve më parë. Duhej t’i fshinte nga kujtesa ato vite. Duhej të lumturohej! E pse jo? A nuk ishte në moshën më të bukur?!

Atë natë Grejsa ndenji zgjuar deri vonë. Televizorin e mbajti fikur me shpresën se do të flinte. Por ç’e do! S’mundej. Disa orë larg tij, ndërsa ai vazhdonte të rrinte ulur si mysafir në zemër. Por..., si një mysafir shumë i veçantë.

U kthye në krahun tjetër. Shtrëngoi fort sytë me shpresën se ai do të largohej. E pamundur! Fjalët e tij vazhdonin t’i binin mbi fytyrë duke i dhënë nuanca të ndryshme. Nuk donte të ngrihej e të ndizte dritën, se menjëherë mami do ta pyste se

çfarë kishte. Ishte e bindur se e kuqja e fytyrës në lokal vazhdonte të luante me të.

Si ishte e mundur të ndihej kështu?! Ndoshta gjithkush do të ndihej si ajo nga fjalët e atij?! Jo, jo. Ato fjalë ishin vetëm për të. I kushtoheshin vetëm asaj. Po sikur të bisedonte me mamën? Në asnjë mënyrë! Ajo vetëm do ta qortonte. Nga i vajti në mendje kjo gjë?! Do të pyeste vetëm zemrën e saj!

Ai! Ai! Ai! Ai në zemrën e saj. Vonë, tepër vonë e zuri gjumi. Por ai, përsëri me të. Në ëndrrën e saj.

Gjithë ditën vrapoi nëpër rrugë pa e kuptuar fare se çfarë kërkonte apo ku po shkonte. Vraponte dhe shikonte pamje të ndryshme, herë rrugë të asfaltuara dhe herë të ndotura. Mezi ecte, por as makinat s'e linin të qetë në vrapin e saj. Dhe për një çast u shndërrua në flutur ku krahët iu shkruan nga dielli me ngjyrat më mahnitëse. Fluturonte e lumtur, por jo mbi lule e pemë, thjesht mbi hapësirë. Qielli me shoqëruesit e saj diellin e retë, qenë të vetët. Por papritur ngjyrat mahnitëse të krahëve u zhdukën. Magji?! Ajo s'fluturonte dot më dhe për një çast po shndërrohej...

- Grejsa! Çohu, se do të bëhesh vonë, – ndjeu dorën e mamit tek i rrëshqiste mbi ballë.

Mezi hapi sytë. Qepallat i rëndonin sikur të mbanin mbi vete një peshë të rëndë. Drita e diellit, si mysafire e paftuar, i ngacmonte shikimin duke ia turbulluar atë dhe duke ia rënduar më tej qepallat.

Më mirë kështu!

Po sikur të kishte parë dhe fundin e ëndrrës?! Ohu!... Ëndrra mbetet ëndërr.

Megjithatë ndjeu se diçka e bashkoi me ëndrrën. Kur u nis për në shkollë iu duk vetja si flutur dhe sytë i vizituan çdo cep të rrugës për të parë atë. Po nuk arriti ta shihte. Patjetër më vonë do ta takonte. Ai do të jetë diku duke e pritur.

- Ç'paske sot kështu Grejsa?! – ishte Sara që pa i thënë “Mirëmëngjesi” e shikoi me dyshim.

- Hajde njëra! Njësh qenke bërë sot! - sikur ta kishte bërë fjalë me Sarën, i foli Turi.

Në atë çast Grejsa vendosi të mos kthente përgjigje nga frika se mos e tradhtonin fjalët dhe ngjyra e fytyrës. Ajo qe bërë aq tekanjoze, sa e vishte dhe e hiqte të kuqtë sa herë të donte. Po kësaj radhe nuk po i largohej. Ishte e vetëdijshme për shkakun e ndryshimit të saj. Aq më tepër për kohën e harxhuar para pasqyrës duke u kujdesur për veshjen shumë më tepër se ditët e tjera.

Bluza e bardhë me një stampë i rrinte puthitur pas belit dhe pjesa e gjoksit me pak rrudha i jepte plotësi të tillë sa tërhiqte mbi vete shikimet lakmitare. Shpatullat e drejta krijonin harmoni me linjat. Xhinset e puthitura pas trupit i tregonin format e vitheve të rrumbullakosura në mënyrë të tillë sikur t'i ishte dhënë forma nga një mjeshtër skulpture që, i kënaqur nga puna, tërhiqet për të kundruar veprën e tij. Flokët e prera shkurt, të kapura pas me një bisht të vogël, i jepnin ëmbëlsi të

tillë fytirës, sa nuk mund t'i shqisje sytë për asnjë çast nga ajo. Megjithatë, Grejsa nuk kishte ndenjur pa vënë pak laps te sytë.

Çdo ditë, Grejsa do t'i përkushtohej më shumë vetes. Do të rrinte para pasqyrës duke hequr e veshur fustane, pantallona, bluza e shpesh duke iu kënaqur dhe lakuriqësisë së saj me format aq të harmonizuara. Kalonte dorën rreth belit dhe vazhdonte duke prekur gjoksin që, ashtu i fortë dhe i butë njëkohësisht, rrinte përpjetë sikur donte t'i krekosej Grejsës. “Unë të shtoj më shumë pikë në bukurinë tënde!”

Efektet e ndenjjes para pasqyrës do të shiheshin çdo ditë e më shumë, sepse ajo tashmë ndryshoi jo vetëm veshjen, por dhe ecjen. Të gjitha këto ndryshime për Atë.

Ankthi po i shtohej edhe më shumë. Kaluan plot tre ditë nga çasti kur ai hodhi brenda saj diçka shumë të nxehtë. Dhe, pavarësisht se asaj i prishi gjumin, ai s'po shihej gjekund.

- Mos vallë gjithçka kishte qenë një vegim?!

“E pamundur!” Fjalët e tij shëtisnin jo vetëm në mendjen e saj, por në të gjithë trupin duke e përkëdhelur aq shumë sa nuk ishte në gjendje të ndalte nxehtësinë përvëluese apo...

- Kushedi se ç'punë mund t'i ketë dalë! Pastaj e ndiej se shumë shpejt do ta takoj, – foli me zë duke harruar se po i drejtohej vetes para pasqyrës. Më duhen rroba të reja!

Ndërsa Ai e ndiqte Grejsën nga larg. Nga shikimet e saj kur kalonte në rrugë u sigurua për “ilaçin” e hedhur. E ku ka ilaç më të mirë se dashuria?!

Ishte i zoti!

Kjo lule e sapoformuar tani, do të ishte e tij.

\* \* \*

Silva ecte përkrah Elit dhe i dukej sikur po fluturonte. Krahë të fuqishëm e mbanin lart për ta çuar drejt vendit që për këto ditë ishte shndërruar në ëndërr. Dhe sot ajo po prekte me dorë ëndrrën. Atë ëndërr të ndaluar për shumë kohë.

Sapo hyri në klasë shpërtheu një duartrokitje e fortë. Nuk munguan kureshtarët e mbledhur në derën e klasës. Silva ndiente duar ta preknin, fjalë mbështetëse dhe kuptoi se ishte në mes të një dashurie shumë të madhe, asaj njerëzore. U hutua fare dhe as e kishte menduar se do ta prisnin në një mënyrë të tillë në klasë.

- Të prisnim Silva! – dëgjoji nga pas zërin e dashur dhe aq të dëshiruar këto kohë.

Iu hodh në qafë mësuese Merit. Lotët i lagën kostumin e mësueses dhe si fajtores u largua duke i kërkuar falje.

- Jo, Silva. Këta janë lot lumturie. Dhe ne jemi po kaq të lumtur për ty.

- Faleminderit mësuese, për gjithçka, - arriti të shqiptonte mes lotëve. Sytë e saj pasqyronin një ngjyrë



tjetër. Mësuese Meri e pa në sy, mbështeti dorën në sup duke e tërhequr pas vetes dhe tha:

- Po kaq e lumtur jam dhe unë për ty. Po kaq të lumtur janë dhe shoqet e shokët e klasës. Shikoji të gjithë. Ata të kanë pritur, sepse ti e meriton të jesh këtu. Dhe patjetër më vonë do të vazhdosh sërish të realizosh ëndrrat e tua. Ne kemi besim... Heshtje. As të ardhurit në atë çast në klasë nuk pipëtinin, por vetëm me shikimin e tyre nga Silva, i tregonin se e donin dhe ishin të lumtur për të. Qetësia dhe siguria në vetvete do të pushtonin Silvën, varësisht se vështirësi të papritura mund t'i dilnin.

- Asnjë rrugë në jetë, sado e asfaltuar, nuk mund të vazhdojë pa pengesa dhe kthesa të papritura. Atëherë mendoj se të gjithë ne do të mbështetim njëri-tjetrin për të ecur para.

- Patjetër mësuese! Po s'u mbështetëm te njëri-tjetri, mund të gjejmë ndonjë patericë për të mos u rrëzuar!

E qeshura, si me komandë, mbuloi fytyrat e të gjithëve.

- Epo, ti nuk rri pa ndërhyrjet e tua, - i drejtua Aronit. Ai, i ngritur në këmbë, me pamjen e një njeriu tepër serioz, sapo bëri pohimin më të këndshëm të ditës.

- Po largohem atëherë, se ra zilja, por në qoftë se keni ndonjë problem, në shkollë më keni sot gjithë ditën. (Gjithnjë mësuese Meri tregonte nëse do ta gjenin në shkollë apo jo, në rast se do të kishin nevojë për të.)

Silva menjëherë u gjend brenda një rrethi. Mungesa e tyre për kaq kohë, malli për gjithçka që mbante brenda kjo klasë, e bënë të ndihej sot si një fëmijë i vogël. Donte të fliste, por nuk dinte se çfarë t'u thoshte. E ndiente veten fajtores për forcën e munguar, por dhe të lumtur pafundësisht për ngrohtësinë e gjetur. Eli e shihte nga fundi i bankave dhe dukej sikur i thoshte, "E sheh se nuk të kam gënjyer? Të gjithë të kanë pritur."

Ndryshimin e mendimit të babait nuk e mori vesh. Ndoshta mund të ketë biseduar mësuese Meri dhe drejtoresha me të. Mbrëmë në darkë babi e thirri dhe pa e parë në sy i tha.

- Nesër shko në shkollë. Po një fjalë të dëgjova, e shkreta ti! Vetëm kaq.

Në ato çaste do të donte të hidhej përpjetë nga gëzimi, ta përqafoje babin fort, fort, por e përmbajti veten. E dinte mirë se ç'pasoja mund ta shoqëronin përsëri në rast se do të bënte qoftë dhe një veprim të pamatur. Në darkë futi çfarë mundi në çantë dhe shqetësimi se si do t'u dilte para klasës e mësuesve mbeti i vetmi problem. Por këtu...

- Ç'ka ndodhur?! - Shikimi i rreptë i mësuese Dritës u shfaq aq papritur sa të gjithë u ulën nëpër vendet e tyre.

- O, paske ardhur ti! Po ç'ne kështu!

- Unë... - dhe Silva s'arriti të fliste më tej.

- Posi moj! Kur të të mbushet mendja ty mund të vish në shkollë. Shkolla ka rregulla. Do të japësh

provim për periudhën e munguar dhe vetëm nëse merr provimin mund të vazhdosh. Gjithsesi, do të flas me mësuese Merin dhe drejtorinë për këtë problem. Dhe, me po atë ton të vrazhdët, vazhdoi:

- Uluni dhe fillojmë mësimin.

Nuk ishte provimi shqetësimi i Silvës në këtë çast, por toni i mësuese Dritës.

- Nuk mund të jenë të gjithë njerëzit njësoj, “ sesi i rrëshqiti ky mendim dhe mblodhi të gjitha energjitë për të mos humbur asnjë minutë nga shpjegimi.

Në shtëpi Silva u tregua shumë e kujdesshme. Entuziazmi duhej të rrinte i struktur, pasi s’do të mund të duronte shikimet dyshuese të babit e fjalët e mamit. Dyshimet në mendimet e saj po përpiqej t’i fshinte fort. I duhej të luftonte për vete, për jetën e saj. Luftë!... Mos është shumë e rëndë, ndoshta dhe paradoksale ta mendosh?!

Por ja, të gjithë po jetojnë në kohën e paradokseve! Këtë e tregonin më së miri lajmet e para që jepeshin çdo natë në televizor.

Ajo ndoshta ishte shumë e re për të menduar apo vendosur se ç’formë karakteri do të merrte. (Sa budallaçkë! Po mendonte sikur karakteri të ishte brumë që e ngjesh me duar për t’i dhënë formën e dëshiruar). Por gënjeshtren dhe hipokrizinë do t’i mbante gjithnjë larg. Shumë larg vetes së saj.

Ndërkohë, u dëgjua zilja e telefonit. Nxitoi ta kapte.

- Familja Bushi ? – e njohu zërin që fliste matanë, ndaj menjëherë i foli.

- Po, Grejsa. Silva jam.

- Silva, do të vish sot nga unë?! Kam plot gjëra për të të thënë.

(Po kjo?!... Unë mezi arrita të shkoj në shkollë sot pas kaq muajsh dhe kjo tani kujton se duhet të dal menjëherë. Nuk kishte shumë kohë të mendohej. E ndiente ankthin e Grejsës në anën tjetër).

- Grejsa, mos të të mbetet hatri, por flasim nesër në shkollë, të lutem.

- Dëgjo Silva, me të vërtetë kam nevojë për ty. Dua të të tregoj diçka, se vetëm te ti kam besim.

- S'më kuptove më duket. E kam të pamundur të dal. Pastaj më duhet të shkoj me mamin nga tezja. Nuk mundem!

Fjalët e fundit tingëlluan të ashpra, ndaj u dëgjua vetëm një "mirë! mirë!" nga ana tjetër e receptorit dhe një "mirupafshim" i vakët.

- Posi moj, filloi telefoni! Nuk ka faj yt atë, jo! - zëri i mamin i erdhi aq papritur sa e trembi Silvën.

- Po pse, moj mami, nuk kam të drejtë të pyes as për detyrat? – dhe një i kuq i lehtë e veshi të tërën nga gënjeshtria e sapo nxjerrë. Të mendosh se sapo i premtoi vetes se nuk do të gënjente kurrë.

- Epo një gënjeshtër e bardhë për të shmangur një konflikt të madh, – u mundua të justifikonte veten.

- I di, i di detyrat tuaja! I bëre punët?

Silva nuk foli. Punët flisnin vetë. Vazoja me lule të freskëta e vënë në tavolinën e ngrënies sikur donte të përcillte bashkë me aromën dhe një atmosferë tjetër

në shtëpi. Ndërsa në mendjen e saj qe ulur tashmë dhe Grejsa me ankthin për të biseduar sa më parë.

Ndryshimet e Grejsës i bënë përshtypje, por mendoj se koha ka bërë punën e saj. Me Grejsën, më parë, rrinte shumë shpesh, pasi vetë mungesa e babait në jetën e saj e bënte që t'i vinte keq. Ndoshta nuk ishte vetëm keqardhje. Ishte dhe një lloj paralelizmi me të vetën

- Më mirë një baba tepër i rreptë si i saji, apo një baba që jeton larg dhe nuk merr pjesë në jetën tënde?

Ndoshta tani nuk mundej t'i jepte përgjigje. Më mirë të mbetej pyetje retorike. Tashmë duhej të mendonte vetëm për shkollën. Duhej patjetër!

\* \* \*

Meri e pa telefonin me një ndjenjë dyshimi. Zarfi në ekranin e tij e ftonte për të hapur mesazhin e ardhur. Për një çast mendoj ta fshinte pa e lexuar fare. Po sikur t'ia ketë nisur Petriti? Ai vonohej shpesh në punë, por asnjëherë nuk harronte ta njoftonte.

Mesazhet e ardhura kohët e fundit vetëm shqetësime i kishin sjellë. Filloi të lexonte:

“Më vjen keq për shqetësimin, por nuk mund të rri pa të shkruar. Nuk kam ç't'i bëj dobësisë sime. Vitet nuk kanë shkruar asgjë mbi ty. Ke mbetur përsëri ajo vajzë me fytyrë engjëjlore. Ngazëllimi im kur të pashë më ka përzier mendimet dhe ndjenjat. Më detyrohesh të paktën një kafe.”

- Idiot! – dhe hodhi telefonin mbi kolltuk.

- Po unë s'bëra gjë! - zëri i djalit e bëri t'i vinte turp për frazën e përdorur.

- Jo, shpirt i mamitë. E si mund të të thotë mami ty ashtu!

- Mami, po ç'do të thotë "idiot?"

- Ah, zemër. Po ja, dhe të rriturit ndonjëherë gabojnë. Ajo fjalë nuk duhet përdorur. Kur të rritesh do ta kuptosh vet.

- Po pse e përplase telefonin ashtu? A s'më ke thënë se gjërat duhen ruajtur?

- O të keqen! Tani, mamit i dhemb pak koka. Flasim ndonjë ditë tjetër?

U largua nga dhoma e ndenjjes dhe u shtri mbi shtrat. Përse duhej të shqetësohej nga budallallëqet e një të papërgjegjshmi? Patjetër i tillë është, pasi kur sheh dikë që ka një familje dhe është e lumtur, përse duhet t'i shkruajë gjëra të tilla? Gjithnjë i vinte për të qeshur kur dëgjonte shoqet të tregonin për ngacmime apo propozime. Asnjëherë nuk ua kishte vënë rëndësinë dhe, për më tepër, nuk i kishte besuar. Vetë mendonte se dashuria është unike.

Tani i vinte inat me veten e saj. Ku gaboi ajo për t'i dhënë shpresa apo ushqyer një ndjenjë të tillë dikujt tjetër?!

E pamundur! Gjithnjë korrekte dhe e kujdesshme në marrëdhëniet me të tjerët. Patjetër do të jetë ndonjë i lajthitur! I mjeri! Nuk do të dijë të dallojë elementet e mirësjelljes. Duhej të mos mendonte më për të e

mesazhet e tij, sepse kështu ai mund të arrinte diçka. Më mirë ta injoronte duke mos i kthyer përgjigje dhe duke mos e hapur telefonin kur t'i dallonte numrin. Le të mbetej njeri enigmatik. Petritin nuk do ta shqetësonte me budallallëqe të tilla. Ishte e zonja e vetes. Nuk ishte më adoleshente që të kishte aq shumë pasiguri.

Adoleshenca. Dashje pa dashje do të bënte paradë para syve të Merit, duke i sjellë ato vite aq të bukura dhe me po aq shqetësime e ndjenja të përziera në mënyrë të atillë sa do t'i prishnin gjumin kujtdo. Buzëqeshi me vete.

“Një mesazh në këtë moshë sillte shqetësime! Aty ku mendja dhe zemra ishin të lidhura aq ngushtë me madhështinë e dashurisë. Po atëherë?!”

- O unë, o ti, o të dy bashkë! – toni kërcënues i Gimit i oshtinte dhe tani në vesh. Ai kishte qenë dy vjet para saj. Ishte në vit të katërt të shkollës së mesme dhe në çdo çast i rrinte si truprojë nga pas. E shqetësonte shumë prania e tij dhe kur kishte dëgjuar fjalët e thëna me aq seriozitet, o Zot, sa qe mërzitur! Atë ditë, qau tërë ditën në dhomë. Nuk zbriti në studim. I trembej shikimit të tij që nuk ngurronte për orë të tëra të ulej dy tavolina më tutje përballë saj e të mos ia ndante sytë për asnjë çast.

Ai bënte të njëjtën gjë për plot dy muaj.

Pastaj shoqërimi në shkollë nga pas, hapat e tërhequr zvarrë duke bërë me shumë korrektësi truprojen besnik, acaronin jo vetëm Merin, por dhe

shoqet e saj. Ndërsa Meri ndihej e brishtë, shumë e brishtë. Edhe kur miklohej me fjalë të ëmbla, ndihej e sigurt dhe e fortë, por...

Ja, atë ditë nuk guxoi të shkonte as në studim. Orë të tëra të shoqëruara me frikën se mos vërtet mund të ndodhte diçka. Pastaj pse duhet t'i ndodhte asaj! Kjo e shqetësonte më shumë. Frazave të dashurisë së Gimit i ishte përgjigjur me një "Jo!" të prerë dhe as i krijoi mundësinë që ai të bisedonte më tej me të. Në zemrën e saj kishte zënë vend urrejtja për një njeri të tillë. Ai nuk dinte të respektonte mendimin dhe ndjenjat e tjetrit.

- Po ti Meri? Pse nuk zbritë poshtë? – zëri i Aldës u shoqërua me një shikim dyshues sapo hyri në dhomë. Meri nuk foli. (Në vitin e dytë gëzonin privilegjin e dhomës me gjashtë veta).

- Ke qarë?!

Përsëri heshtje nga ana e Merit.

- Unë mund ta di shkakun, - dhe Bona u hodh mbi shtratin e Merit.

- Diçka dëgjova në studim.

(Kështu ndodhte në konvikt. Fjala përhapej me shpejtësinë e erës).

- Ne kemi premtuar se do t'i tregojmë gjithçka njëra-tjetrës. Atëherë ti Meri po shkel një premtim tonin, - vazhdoi Alda me pamjen e së fyerës, sepse i kishte shpëtuar diçka pa e marrë vesh.

Lotët filluan t'i rrëshqisnin Merit mbi faqe pa i marrë leje. Të dyja shoqet u shqetësuan vërtet shumë



dhe iu afruan më pranë. Mes lotëve Meri u tregoi për fjalët e Gimit.

Atëherë dhoma oshtiu nga e qeshura e fortë e Aldës. Meri, e hutuar, e pa me dyshim.

- Për këtë je mërzitur?! E ç' mund të të bëjë ai?

- Alda, mos qesh se asgjëje nuk i dihet, - dhe shqetësimi në zërin e Bonës pati efekt te Meri. Lotët vazhdonin pa u ndalur.

- Mos u marrosët ju të dyja? Po pse, do të lëmë ne të na shqetësojë një i lajthitur? Qysh sonte ia tregojmë vendin.

Shikimi pyetës i vajzave u shoqërua përsëri me fjalët e Aldës.

- Kur të zbresim për të ngrënë, ia rregullojmë qejfin.

- Unë jo! - foli prerë Meri.

- Dëgjomë, moj zemra ime. Ti vetëm do të zbresësh poshtë me ne. Tamam, tamam do të ecësh një hap para nesh. Të tjerat i rregullojmë unë e Bona.

Meri nuk qe dakord, por Bona buzëqeshi pasi dëgjoi Aldën që i foli diçka me zë të ulët.

Në orën shtatë të tria gati në rresht zbritën për në sallën e ngrënies. Në katin e dytë, si gjithnjë, bodigardi bënte rojën dhe shikimi i tij shoqëronte Merin në çdo hap.

- Meri kaloi para tij me merakun se çfarë do të bënin shoqet e saj.

- ×mo ýmo? – dhe Alda u ndal përpara Gimit duke treguar me dorë nga një llambë e ndezur në tavan.

- Ýmo poç, – ia pret e qetë Bona.

Të dyja zbritën shkallët duke qeshur, ndërsa ai mbeti si i ngrirë aty në hollin e katit të dytë. Ishte diçka e përgatitur për të apo...

I duhej të priste aty derisa të ngjiteshin vajzat përsëri.

Dhe përsëri ajo skenë e përsëritur, duke treguar jo llambën, por atë vetë.

Që nga ajo natë Meri shpëtoi nga ai. Hapat e tij u fashitën nga pas. Në studim mund të rrinte e qetë, pasi njeriu i bezdisshëm nuk i rrinte më përballë. Më në fund mund të merrte frymë lirisht. Ndihej e lirë.

*Shënim:* - ×mo ýmo? (në gjuhën ruse, ç'është ky?)

- Ýmo poç. (Është poç. Poç në shqip, llambë).

Lidhja me Petritin! Kjo lidhje erdhi natyrshëm. Rrahjet e zemrës sa herë e shihte atë, i jepnin një ngjyrë pak në rozë. Nuk iu desh shumë kohë të ndiente shikimet ngacmuese të shoqeve mbi vete. Me dhjetra herë i ishte dashur t'u pohonte se asgjë nuk kishte mes tyre, përveç një miqësie të sinqertë. E ndiente të domosdoshme ta shihte çdo ditë dhe të shkëmbenin mendime apo dhe të diskutonin për probleme të ndryshme shoqërore. Kishte ç'të merrte nga biseda me të. Dalëngadalë ishte bërë jo vetëm një dëgjuese, por dhe përkrahëse e flaktë e ideve të tij, thua se në të ardhmen do të punonin së bashku në ndonjë shoqatë.

U ngrit nga shtrati, mori e sigurt telefonin dhe pasi gjeti mesazhin, shënoi numrin e njeriut të mesazheve.

Më pas e fshiu atë numër dhe nga nervozizmi të gjitha mesazhet, edhe pse disa prej tyre qenë ruajtur me fanatizëm. Me nervozizmin shoqërues të pandarë, i ra numrit të porsa shënuar. Priti. Sekretaria. I ra disa herë. Sekretaria përsëriste të njëjtat fjalë “Numri i kërkuar nuk është i disponueshëm.”

Nervozizmi për këtë njeri misterioz që kishte vendosur ta shqetësonte iu kthye me një forcë tjetër. Dyshimet se përse dikush duhet të sillej në mënyrë të tillë ishin nga më të ndryshmet, por emëruesi për të gjitha këto ishte i madh dhe i njëjtë. Njeri idiot.

Nuk do ta linte të luante me ndjenjat e saj. Do ta kërkonte në telefon përsëri dhe ndoshta mund t’ia krijonte privilegjin e kafesë. Një njeriu të tillë, do t’ia thoshte me zë të lartë mendimin e saj.

Më mirë t’u përvishej punëve e të mos e mbante mendjen aty. Sapo erdhi Petriti, ndjeu aromën e këndshme që vinte nga kuzhina.

- Epo dihet se do të kemi drekë të mirë! - i foli Merit dhe i dhuroi një puthje në faqe.

- Po mua, babi!

- Kush të lë pa të dhënë puthje ty, por ngadalë se ti e ke atë të shoqëruar me çokollatë.

- Aman Petrit! Mos i jep gjë pa ngrënë darkën.

- Mos ki merak, mami, se vetëm pas buke do ta ha,  
- dhe nuk priti më, por u largua duke hapur fshehurazi letrën e çokollatës.

- Po ti, qenke me shumë humor sot, - i tha Meri jo pa xhelozit për qetësinë dhe humorin e pranishëm pothuajse gjithnjë tek i shoqi.

- Ti e di, e dashur, se me humorin nuk jam keq.

- Epo lum ti, atëherë! - dhe u largua për të shtruar tryezën, duke u përpjekur shumë me veten që shqetësimin e saj të mos e përcillte te Petriti. Kushedi si do të ndjehej ai. Pastaj, edhe në punë mund të ketë pasur probleme. Nuk kishte arsye ta ngarkonte më tej. Duhej t'i dilte zot vetes.

- Ndonjë problem nga shkolla?!...Moj, se s'të kam pyetur, ajo vajza e larguar nga shkolla, nuk ka ardhur më? - ndjeu të shoqin nga pas dhe frymëmarrjen e tij te supi.

- Ah, po. Silva po vjen rregullisht dhe e shoh se ka më siguri te vetja. Ç'krim është t'ia presësh rrugën në mes fëmijës tënd!... Ende s'e kuptoj se si menduan prindërit e saj t'ia bënin këtë gjë Silvës.

- Po në marrëdhëniet me shoqet e shokët si ndihet?

Meri ishte mësuar të diskutonte me Petritin për nxënësit e klasës dhe nuk ishte aspak rastësi për Petritin t'i njihite nxënësit dhe problemet e tyre. Qysh kur u dashuruan, u mësuan të ndanin gjithçka bashkë. Meri ndihej fajtores që tashmë po mbante diçka për vete. Këtë gjë po e bënte për të vetmen arsye, që të mos e shqetësonte. Pastaj duhej t'ia dilte mbanë vetë.

Pasi i tregoi për Silvën, filloi ta pyeste për fushatën. Petriti ishte entuziast. Në takimet me elektoratin e tij,

qe i hapur. Nuk i pëlqente të hidhte premtime pa baza. E shqetësonte fakti se nëse fitonte, të ishte i ndershëm me ta. Të arrinte të mbante fjalën.

- Më duket se ky ka qenë shkaku që më bëri të dashurohesha me ty.

- Vetëm ky? Asgjë tjetër s'të pëlqeu tek unë?! – toni i Petritit u shoqërua me një shikim dyshues.

- E pse? Çfarë kishe të mirë tjetër ti?! – dhe Meri po e shikonte ngultas në sy si për ta bërë më të besueshme atë që tha.

- Ashtu ë! Asgjë tjetër! Dhe e thua me bindje.

E qeshura e Merit dhe batutat e Petritit shoqëruan atë mbrëmje. Meri donte të harronte sadopak shqetësimin e mesazheve.

Atëherë kur gjumi po rrëshqiste ëmbël mbi të dy, u ndje sinjali i një mesazhi në telefonin e Merit.

- Do të jenë ata të Vodafonit. Njëqind oferta të çojnë, - foli Meri përgjumësh. Mori telefonin dhe e futi në sirtar pa e hapur mesazhin.

“Po unë si s'e lashë telefonin në çantë!” Hodhi vështrimin nga Petriti. Ai po flinte i qetë. Ndërsa Meri nuk do të flinte më. Telefonin nuk e hapi, por shqetësimi për mesazhet filloi të shëtiste gjithë natën në mendjen e saj.

\* \* \*

Të gjithë po bisedonin me zë të lartë te fast-fudi ku shkonin shpesh në pushimin e madh, pa pyetur për

klientët e tjerë nëse shqetësoheshin apo jo nga e qeshura e tyre.

- Me të vërtetë ke kaq shumë frikë nga qentë? – iu drejtua Ela Genit, i cili sapo nxori një sekret të tijin pa dashje.

- Epo ja, e vërtetë është. Makthi im janë ata.

- Unë vdes të mbaj një këlysh pas, sidomos nga të racës, ama, – foli Grejsa.

- Po hajde thuaja mamit tim se.

- E keni dëgjuar atë barsoletën? - dhe pa pritur përgjigjen Miri ia nisi.

.....

E qeshura e tyre tërhoqi vëmendjen e të gjithë klientëve. Të sapoardhurit në fast-fud shikonin me mëdyshje. Dikush vinte buzën në gaz.

- Do të ketë mbaruar pushimi, – u kujtua Grejsa dhe u ngrit e para nga tavolina. Ndërkohë, sytë e saj u ndeshën me...

Një e dridhur i përshkoi trupin. Ishte ai. Kaq kohë pa e parë dhe ja ku shfaqej. Uli kokën me pretekstin se po rregullonte karrigen dhe bëri të dilte bashkë me të tjerët.

- Të pres këtu pas mësimit, - dëgjoi nga pas.

- Unë këtu do..., por fjalët e tjera nuk i dëgjoi, se ishte larguar bashkë me shokët e shoqet.

- Ku ka qenë ai tërë këto ditë?- pyti veten Grejsa. Ëndrrat e thurura për të rrinin pezull. Pastaj i vinte turp nga Silva pas pohimit të bërë për dashurinë e saj

dhe ai asgjekund. Tani ai i shfaqet nga asgjëja dhe e fton. Jo! Nuk do të vinte ta takonte. Kështu mendoj atë çast.

Dy orët e mësimit për Grejsën qenë më shumë detyrim për të ndenjur dhe për të vendosur nëse duhej të shkonte ta takonte, sesa po mbante mendjen në mësim. Ishte e pamundur. Shikimi i tij ishte det, qiell. E kishte ndier këtë shikim në errësirën e natës, aty ku ëndrrat nuk kanë kufi, dhe ja po ky shikim i shfaqet papritur.

Pas mësimit nuk ngurroi të shkonte te fast-fudi. Sytë e tij si magnet e tërhoqën në tavolinën ku qe ulur para disa orësh. Si duket ai nuk kishte lëvizur nga vendi.

- Më ka marrë malli, - foli sapo Grejsa zuri vendin përballë.

*Heshtje.*

- Po ty?! Më ke menduar ndopak?

Vështrimi i Grejsës, jo pa qëllim, u ul mbi sytë e tij. Kërkonte të gjente diçka tek ata sy.

- Përse?!

- Si përse?!

- Përse duhet të të mendoja?!

- Sepse, zemra ime, unë jam brenda teje. Nuk e ke kuptuar?

Sytë e Grejsës nuk lëvizën. Dëshira dhe malli për të thithur ëmbëlsinë e këtyre fjalëve e veshën me një mburojë të padukshme. Kjo mburojë përpiqej të mbante me forcë ndjenjat që lëviznin rrëmbyeshëm

brenda saj. Duhej! Kishte vuajtur shumë këto ditë nga mungesa e këtij shikimi, e këtyre fjalëve.

Ndjeu diçka të nxehtë t'ia mbështillte dorën. Fjalët vazhduan rrugën e nisur.

- E di se kam qenë çdo ditë me ty?

- Ku?!

Ironia e Grejsës kushedi si doli nga tërë ajo vorbull që e kishte përfshirë. Por... ai nuk lëvizi asnjë qerpik. Vazhdonte ta përpinte me sy të etur. Si ushtarë të bindur ata sy qenë ngulur mbi të. Ajo në këtë moment ishte tabelë mbartëse e shigjetave të këtij shikimi.

- E di se e ke ndier mungesën time. Asgjë nga fjalët e mëparshme nuk vinin nga hapësira boshe, por nga ndjenja të lindura që në momentin kur të pashë për herë të parë. Kjo ndjenjë na ka lidhur pazgjydhshëmrisht të dyve. Duam apo s'duam ne.

- S'të kam parë plot shtatë ditë, - e lëshoi veten Grejsa. Fjalët i dolën të pavullnetshme. I pëlqente të dëgjonte fjalët e tij me nota aq të dashura tek e përkëdhelnin ëmbël. Por fjalët, këta tinguj të lidhur ngeshëm bashkë, formuan një harmoni të tillë, sa s'mund të fshihte asgjë më. As ndjenjat që e munduan kaq shumë këto kohë.

- E dija, e dija, e dija, - dhe njomështia e buzëve të tij mbeti si dëshmitare e një puthjeje të sapo marrë.

Nuk po kuptonte më asgjë. As u mundua të shihte më tej për të parë nëse ishte shndërruar në objekt shikimi për të tjerët. Nuk donte t'ia dinte më për asgjë. Ndihej e lumtur.



A nuk ishte kjo më e rëndësishme për të? Të shijonte këtë lumturi të sapo afruar?!

- Zemra ime. Nuk kam qenë këtu, është e vërtetë.

Shikimi pyetës i Grejsës bëri të vazhdonte.

- Babai im ka një hotel në qytetin S. Megjithëse kemi një grup administratorësh që kujdesen për mbarëvajtjen e punëve, më duhet shpesh të kontrolloj se si i thonë: “Mos vrafsh as gjarprin me duar të huaja!”

- Sa mirë! Një hotel në S! – nuk iu durua Grejsës.  
– Duhet të jesh shumë i kënaqur për këtë.

- I kënaqur jam vetëm kur të kam ty pranë. Asgjë tjetër nuk më bën përshtypje.

- Jo, por...

- Nuk e kupton se nuk ka pasuri që të më zëvendësojë lumturinë që më dhuron ti?! Paratë! Disa letra nëpër duar! Shkojnë e vijnë.

- Po, po. Por ama nuk të duhet shumë mund për t'i siguruar kur ke një hotel!

- Epo besoj se tani ndihesh më mirë. Sa herë që mungoj do ta dish se ku jam, pasi më duhet të shkoj shpesh atje. Gjithsesi, do të të njoftoj më parë. Kështu nuk do të mendosh keq.

Grejsa vetëm sa uli sytë. Tashmë u siguria se nuk do të torturohej nga mendimi se ai mund të largohej nga ajo. Ai ishte aty për të dhe kështu do të vazhdonte të ishte. Ai!

U rrëqeth. E kishte përballë. Çdo qelizë e saj mendonte për të dhe ajo nuk i dinte as emrin. Ankthi pushtues iu lexua menjëherë në fytyrë.

- Çfarë ke, zemër?  
- Përse?!  
- Duket sikur diçka e hidhur t'u kujtua, ose më mirë...

- Po, ti...?  
- Prej meje s'duhet të kesh droje. Çfarë të mundon?  
- Unë emrin nuk ta di akoma, - zëri i mekur i Grejsës mbështeti atë që po e mundonte.

- Bobo, ç'matuf! Tamam matuf jam treguar. Gjithsesi, fajtoje je ti. Ti më ke trullësuar. Atëherë, zonjusha ime e ëmbël, unë jam Ladi, ose më saktë Vladimiri, - foli duke u ngritur në këmbë dhe duke vënë dorën në kraharor me mirësjelljen e një aktori.

Grejsa ia plasi të qeshurit nga ky veprim.

- Ta gëzoni emrin, zotni Vladimiri!

- Ah, jo! Duhet të më thërrisni Ladi, vetëm Ladi.

- Por një njeriu që ka nën administrim një hotel, nuk mund t'i drejtohesh pa fjalën zotni përpara. Apo s'është kështu? – ndërkohë sytë e saj rrugëtuan drejt orës. Kjo orë, sikur të ishte vënë qëllimisht përballë, i kujtoi se ishte tepër vonë për në shtëpi. Shqetësimi i veshi menjëherë fytyrën. Mori një pamje tjetër.

- Mos u shqetëso zemër! Në shtëpi të çoj unë për një minutë, pasi kam makinën aty.

- Jo, por... Jo, jo. Më duhet të çohem. Nuk e di se çfarë justifikimi do t'i them mamit për vonesën, se ndryshe...

- Ndryshe çfarë? Më ke mua për të të mbrojtur nga gjithkush.

- Dhe nga mami do të më mbrosh? – nënqeshi Grejsa.

- Patjetër! Dhe nga mami! – vendosmëria në zërin e Ladit e bindi Grejsën se ai kishte zënë tashmë vendin më të rëndësishëm në jetën e saj. U ngrit. Në çastin kur i zgjati dorën për t'u përshëndetur, ndjeu një forcë ta tërhiqte drejt vetes dhe pëshpërimën në vesh “Nesër në orën 4, te lokali T”.

Nxitoi. Kaloi dorën mbi faqe si për t'u bindur se aty ndodhej ende gjurma e puthjes të sapo marrë. Dhe dora do të kalonte qindra herë atë ditë mbi faqe për të parë se ajo puthje qe aty.

\* \* \*

- Silva! – jehona e forcës së zërit bëri të ndalte hapin dhe të kthente kokën bashkë me Elin. Ishte Grejsa.

- Vazhdo Eli. Shihemi në klasë, - iu kthye Silva, sikur ta kuptonte nga larg se Grejsa kishte diçka të rëndësishme për t'i thënë.

- E quajnë Ladi, - foli Grejsa sapo u afrua, pa thënë akoma “Mirëmëngjesi!”.

- Kë quajnë Ladi?

- Atë pra, Silva. Djalin për të cilin të tregova.

- ???

- Hë moj, po ta them më shkoqur. Djali që unë dua apo jam lidhur, e quajnë Vladimir. Shkurt i thërrasin Ladi.

- Ule zërin Grejsa, se e dëgjuan të gjithë, - më shumë mërmëriti Silva.

- Le të dëgjojnë! As më bëhet vonë. Nëse mua më duhet të jetoj lumturinë time, përse duhet ta fsheh nga të tjerët? Më duhet ta shijoj këtë lumturi që sapo më ka trokitur.

- Më bëhet qejfi për ty, por më duket se po nxitohesh. Ti ende nuk e njeh mirë.

- Dëgjo Silva, - vazhdoi Grejsa duke e ndalur në mes të korridorit. – Ladi është i gjatë, me trup të lidhur e të drejtë, flokë të zinj, sy....

- Nuk po të them për pamjen. E rëndësishme është ta njohësh nga brenda. Pastaj, është në shkollë apo në punë?!

- A, këtu po. Ke plotësisht të drejtë. Dëgjoje mirë këtë.

- !!!

- Ai merret me menaxhim biznesi. Ka një hotel në qytetin S. Prandaj s'e kam parë këto ditë.

- Po ju pse nuk jeni në klasë?! – zëri i profesorit të fizikës u dëgjua nga pas. Të dyja nxituan për në klasë, sikur të mos kishin qenë duke biseduar për probleme aq të mëdha.

Atë ditë Silva gjatë orëve të mësimit e vështroi shpesh Grejsën. I bëhej qejfi tek e shihte aq të lumtur, sepse dukej dhe më e bukur. Ëmbëlsia i kishte

pushtuar çdo milimetër të fytyrës së saj. Kjo ëmbëlsi i jepte shijen e qershisë (qershia ishte fruta më e pëlqyer e Silvës), përzier me bukurinë e luledeles. Ç'tablo e mrekullueshme do të dilte! Qershitë pranë luledeleve. Nuk kishte parë deri tani asnjë tablo të tillë.

U kënaq nga kjo gjetje e çastit dhe shikimi endacak vazhdonte të zhbironte mbi Grejsën. Ngjyra e lëkurës ishte e pakrahasueshme; e bardhë me nuanca rozë e të purpurta. Ngjyra rozë shëtiste me endje mbi të gjithë fytyrën, duke i dhënë një ëmbëlsi të pakrahasueshme. Pastaj sytë. Sytë e saj kishin shumë shkëlqim. Kishte diçka të veçantë aty. Dukej sikur natyra mëmë kishte mbledhur gjithë shkëlqimin e saj për t'i vendosur brenda atyre syve. I dukej më e bukur se kurrë.

Por..., diçka e mundonte Silvën. As vetë nuk mund ta shpjegonte hijen e dyshimit që po e gërryente për lidhjen e Grejsës. Diçka nuk kishte kuptim në tërë këtë. Me një të parë u dashuruan? Kaq shpejt u lidhën?!...

Megjithatë, më mirë të mendonte për problemet e veta. Pas disa muajsh e mbyllur në shtëpi, po vazhdonte ritmiku jetën. Sikur fjala “dashuri” të shqiptohej vetëm një herë në shtëpi pale ç'do të bëhej. Por, mendimet për përjetimet e Grejsës nuk mund t'i largonte lehtë. Ato ishin ulur këmbëkryq diku brenda saj e s'donin të lëviznin. Ndjenja e fajit i rrëshqiti vullshëm në të gjithë trupin. Nuk mund të mos pranonte faktin se shoqja e saj kishte aq besim tek ajo. Mezi priste t'i tregonte gjithçka.

“Përse tek unë?! Tek unë ku mendësia e vjetër dhe fanatizmi më rrethojnë aq egërsisht, sa ndjenja të tilla duhej të jenë të huaja, tepër të huaja.”

Megjithatë, në këto çaste vendosi të mos zhgënjente besimin e Grejsës! Sido të shkonin punët, ajo do të ishte e sinqertë me të. Sido...

\* \* \*

Cingërima e telefonit të Merit vazhdonte të binte pa pushim. Shikimi i saj i ngulur mbi numrin e dalë në ekran e bënte të ndiente peshën e madhe të asaj teknologjie aq të vogël mbi dorë. Shpresoi më kot të pushonte ajo zile çmendurake. Për një çast mblodhi veten. “Përse duhej të ngurronte? Më mirë t’i jepte fund sa më parë këtij të çmenduri.” Shtypi butonin dhe afroi telefonin për të shuar njëherë e mirë tronditjen e dhuruar nga ky njeri.

- Alo!

- Ah, profesoreshë! Më në fund!

- Çfarë më në fund! Mund ta di se kush jeni? – zëri i prerë i Merit e bëri dikë të fërgëllonte në anën tjetër.

- Si të të prezantohem profesoreshë, nuk është momenti i duhur!... Ti e di më mirë se kushdo se gjithçka thuhet dhe bëhet në momentin e duhur.

Meri u mundua të kapte ndonjë notë të njohur në atë zë. Asgjë.

- Më dëgjo atëherë, zotëri, dhe fiksoji mirë këto fjalë, - një ton epërsie sundoi ajrin për ta përcjellë në

anën tjetër. – Për asnjë arsye nuk dua të më shqetësoni në telefon, as me telefonata dhe as me mesazhe. Cilido të jetë qëllimi juaj, nuk më intereson.

- Ju lutem mos e mbyllni, - nxitoi zëri në anën tjetër duke parandier atë që mund të ndodhte në ato çaste. Ishte fare e qartë. Toni i përcjellë nga receptori nuk linte vend për të menduar ndryshe. – Vetëm një kafe për të zbardhur enigmën ekzistuese mes nesh dhe atëherë vendosni ju. Në qoftë se do të merrni mundimin të pini një kafe me mua, do t'ju sqaroj gjithçka.

Heshtje. Ai po priste përgjigje në anën tjetër, ndërkohë Meri ngurronte. Ndoshta duhej një sqarim njëherë e mirë me këtë njeri të bezdisshëm. Ç'enigmë do ta lidhte me të?!

Dyshimi, sundues i mendimeve të saj, ndoshta do të fanitej. Dhe atëherë do të rifitonte qetësinë e humbur gjithë këto kohë.

- Mirë! Një kafe për të të hequr mundimin e të shkruarit mesazhe personit të gabuar, – me gjithë kacabunjtë që i kishin pushtuar gjithë trupin, Meri arriti t'i nxirrte fjalët krejt shkoqur.

- Faleminderit...! - por sinjali në anën tjetër bëri të ndiente një gërvishtje të vakët e cila mbeti pezull. Megjithatë dhe kaq atij i mjaftonte. “Epo punët e mira bëhen dalëngadalë!”

Ndërsa te Meri, dyshimi, nëse kishte vepruar si duhet, mbeti diku në mendjen e saj duke përzier në çdo çast mendimet. Debati i nisur aty pa e pyetur,

vazhdonte vrullshëm, ndërsa zgjidhja rrinte pezull pa guxuar të ulte këmbët e për të zënë vendin e duhur.

“Ç’budallaçkë! Hajde, hajde! Ç’të presësh më nga adoleshentët!”

Të nesërmen në orën 4, Meri ishte ulur në një tavolinë pranë dritares në lokalin “T”. Jo pa qëllim zgjodhi këtë vend sa më të dukshëm për të mos i lejuar krijimin e një mjedisi intim zotërisë X. Dyshimi nëse kishte vepruar mirë vazhdonte të endej, por ajo tashmë kishte marrë një vendim, i cili po rriste këmbët e justifikimit. Ndjeu zhurmën e të rrrufiturit së kafesë, ndërsa sytë po shëtisnin pa iu bindur vetëdijes.

- Mundem? – zëri që e shkëputi nga ajo gjendje i përkiste një fytyre aspak të njohur për Merin. Një burrë i cili nuk duhej t’i kishte të 40-tat mbi vete, me flokë të hedhura mënjanë dhe një buzëqeshje triumfuese në fytyrë, qëndronte para Merit duke pritur përgjigjen e saj.

- Ju jeni...

- Ai i telefonit. Më falni për mënyrën, por ishte e vetmja mundësi për t’u lidhur me ju, - dhe nuk priti përgjigje, por u ul përballë duke mos e shkulur për asnjë çast shikimin nga sytë e saj.

Meri u ndie në siklet.

- Atëherë çfarë kishit për të sqaruar, sepse nuk kam kohë! – nxittoi Meri të fliste, për të ndërprerë atë ligjëratë të shpejtë që kushedi se kur mund të mbaronte.



- Ah të lutem, patjetër nuk do t'iu humbas kohë. Për asnjë arsye nuk do të doja të hynit në telashe, - nxitoi përsëri. Ndërkohë, me përplasjen e dy gishtave kërkoi t'i vinte pranë kamerieri.

- Çfarë do të merrni profesoreshë?, “ sigurisht pas kafesë.

- Siç e shihni, mora çfarë desha, – ironizoi Meri pa pyetur për praninë e kamerierit që s'e kuptoi se kur mbiu aq papritur aty.

- Një koktej special për zonjën, një kafe të shkurtër për mua dhe një konjak, - vazhdoi sikur të mos kishte dëgjuar asgjë nga fjalët e Merit.

- Qenka çudi me ju! – nervozizmi në tonin e Merit e bëri kamerierin të kthente kokën instinktivisht.

- Të lutem mos m'u drejto me ju, pasi e di mirë barrierën e atij përemri. Mos harro, kemi bërë të njëjtën shkollë, pavarësisht se punojmë në fusha të ndryshme.

- More zotëri! Nuk po të kuptoj aspak! Mos po luani gjë teatër? Atëherë po ju them se jeni në vendin e gabuar dhe me njeriun e gabuar, - iu hakërrye Meri. Nervozizmi që e pushtoi filloi të vallëzonte dhe në majat e flokëve të saj. As i shkoi ndërmend se ndodhej në një mjedis, ku sy kureshtarë e vështronin pa mëshirë, ngultas.

Ndërsa ai nuk e largonte për asnjë çast shikimin tinëzar. Nuk foli.

- Atëherë unë kafënë e piva. Meqë “të detyrohesh në një kafe” po çohem, edhe pse nuk e kuptova aspak

arsyen e këtij detyrimi. Vetëm po ju paralajmëroj: Më lini të qetë. Mos guxoni..., – dhe ndërsa fliste me të njëjtin nervozizëm e po ngrihej në këmbë, njohu nga larg vështrimin e Grejsës. Dalloi se ishte e shoqëruar me dikë, ndërkohë ndjeu një dorë që e kapi për krahu për ta ulur përsëri në vendin ku ishte më parë.

- S'mund të bësh skena të tilla! Aq më tepër njohja juaj në qytet si bashkëshortja e kandidatit për kryetar Bashkie.

Në buzë iu ravijëzua ironia dukshëm.

- A..., e njohke tim shoq, dhe guxon ...

- Unë s'po guxoj asgjë! – toni i ndryshuar kaq papritur i burrit përballë e bëri Merin të ulej e të shikonte në fytyrën e tij ngultas. Asgjë s'mundi të lexonte aty. Për herë të parë iu duk vetja e shushatur. Nuk po kuptonte asgjë. Një njeri që e kishte shqetësuar gjithë këto ditë me mesazhe, ai shikim kur erdhi dhe ky qëndrim tani.

- Ah, po. Më duhet të dëgjoj enigmën e madhe që do të më servirni tani, “ Vështrimi paralajmërues i saj tregonte se nuk do të kishte më një herë të dytë.

Ndërsa tjetri rrufiti kafënë gjithë kënaqësi, duke treguar haptazi se ishte ai krijuesi dhe fitimtari i kësaj situate. Ndërsa brenda mendjes së Merit kacabunjte lëviznin me shpejtësi marramendëse.

U sforcua shumë për të përmbajtur veten. I duhej t'i jepte zgjidhje sa më parë një situate të tillë.

Pas disa minutash të vështrimit të mësuese Merit në lokal, Grejsa i kërkoi Ladit që të ngriheshin. Nuk ndihej rehat, edhe pse ishte mëse e bindur se mësuese Meri nuk e kishte mendjen fare tek ajo. Nuk donte të ndihej në këtë gjendje, pasi ishte e vendosur në zgjedhjen e bërë. Duhej të përballej me gjithkënd. Ishte zgjedhja e saj dhe i përkiste vetëm asaj.

- Do të të njoh me diçka tjetër, - ndjeu një murmuritje melodike rrzëzë veshit sapo dolën nga lokali.

- E çfarë? – përkëdhelja në zërin e Grejsës u shoqërua me ëmbëlsinë e syve të saj.

- Është surprizë. Ç'suprizë do të ishte po të ta tregoja?!

Nuk pyeti më tutje. Në të dy muajt e takimeve të rregullta me Ladin surprizat e tij i kishin pëlqyer. E si mund të ishte ndryshe kësaj here?

Rruga me makinë nuk ishte e gjatë, ose ashtu iu duk Grejsës.

Njëra dorë e Ladit rrinte më shumë mbi gjurin e saj duke i dhuruar një ndjenjë sigurie. I mbylli sytë për disa minuta. Po jetonte një ëndërr apo...? Qe mëse e bindur, se momentet me Ladin nuk donte të mbaronin kurrë.

- Grejsa, po fle? – zëri i tij e bëri të kuptojë se sapo kishin ndaluar.

- Jo, jo. Po ku jemi?

- Tani e dashura ime, - dhe më të shpejtë zbriti nga makina, hapi derën nga ana e saj dhe i zgjati dorën gjithë delikatesë.

Tamam si në përrallë.

E ndoqi Ladin nga pas pa e pyetur se ku po shkonin. Do t'i dukej vetja si vogëlushe duke pyetur për gjithçka.

Pamja e apartamentit ku sapo hyri, e mrekulloi. Një hapësirë e madhe, ku mobiliat ishin vendosur me shumë shije dhe luksi shëtiste ngeshëm në këtë hapësirë.

- Të pëlqen?

Grejsa nuk foli. U end nëpër atë sallon të madh pa mundur t'i ndalte sytë në një vend. Gjithçka e mrekulloi.

- Kjo mund të jetë streha jonë, gjithnjë nëse të pëlqen ty, - dhe shikimi i Ladit endej njëkohësisht me atë të Grejsës sikur donte ta udhëhiqte në këtë shëtitje paturpësie.

- Mund të shëtisësh kudo! Unë po përgatis diçka.

Atëherë Grejsa vendosi të përqendrohej. Dukej si shtëpi ëndrrash. Lyerja me shumë shije e mureve, zgjedhja e llambadarëve dhe në fund pikturat.

Pikturat ishin një surprizë më vete në këtë shtëpi. Brenda tyre jepeshin kaq shumë copëza jete, sa... Filloi të rrëshqiste mbi to duke lexuar emrat e piktorëve dhe ndërkohë i dukej sikur po udhëtonte përmes fantazisë së tyre.

Mbeti përballë një pikturë të trishtueshme. Çudi!

Sytë e zgurdulluar nga tmerri, duart e holla të vëna mbi faqe (më shumë mund të thuash ishte një kokë skeleti), goja e hapur dhe trupi që nuk shquhej, pasi ishte i përzier me ngjyrat e sfondit. Qielli i kuq në vishnje në formë dallge dhe bluja në të zezë e detit që përpiqet të gllabërojë gjithçka.

U afrua më pranë për të dalluar emrin e piktorit që ka dashur të japë këtë tmer. Mezi arriti të lexonte E. Manç. “Duhet të jetë imitim!”

- Është origjinale, - dëgjoji nga pas zërin e Ladit. Ai po afrohej me dy gota në duar.

- E pamundur! Eduart Manç i përket më duket viteve 1870-1940. Pastaj kjo pikturë!... Kam lexuar se është një nga pikturat më të riprodhuara në historinë e artit. Vetë E. Manç ka bërë afërsisht pesëdhjetë variante të saj. E pamundur të jetë këtu piktura e tij!

Pastaj, po të mos kisha lexuar për këtë artist, për pikturën do të thosha se s’duhej të rrinte në një mjedis të tillë. Sikur nuk shkon që gjithë bukurisë së këtij salloni në fund t’i mbetesh vetëm tmer.

- Gëzuar bukuroshja ime! Gëzuar për finesën tënde në komentimin e pikturave dhe, - s’priti Ladi, por përplasi zhurmshëm gotën. Nuk priti as pyetjen e Grejsës për pijen e servitur. – Është shija më e mirë që ke provuar ndonjëherë me buzët e tua të ëmbla. Është shija e dashurisë, - vazhdonte Ladi duke nxitur Grejsën për ta pirë krejt pijen në gotë.

Në fund një nënqeshje triumfi u lexua në sytë e tij.

- Nuk mund të të lë me këtë ndjenjë trishtimi nga kjo pikturë. Tani do të të tregoj magjinë e vërtetë të artit.

- Grejsa puliti sytë e hutuar. Zëri i Ladit mjaft bindës i nanuriste ëmbël dhe i dukej si një melodi kënge. E dëgjonte dhe i bindej aq përlësisht sikur ai të ishte Zoti dhe ajo konia më e bindur në rruzull.

U ndodhën përballë një shtrati të madh, ku çarçafët e atlasit të kuq dhe jastëkët e shumtë të vendosur mbi të, të ndillnin brenda lëmueshmërisë së tyre.

- Këtë doja të të tregoja! – dhe dora e Ladit u drejtua nga piktura e një femre nudo që përpiquej të mbulonte linjat e harmonizuara të saj në një copë të bardhë. – E bukur, ë?!

Grejsa nuk foli. Nuk e kuptonte as vetë çfarë po ndodhte me të. Piktura me të vërtetë ishte tejet e bukur. Dukej sikur të ishte tredimensionale. Dëshira për të vënë kokën mbi ato jastëkë të mëdhenj ishte më e madhe se komentet.

Pastaj lakuriqësia e asaj femre aq të bukur bëri të ndiente fërgëllima të lehta në trup. Ktheu sytë nga Ladi. Kushedi sa keq do të dukej në sytë e tij në këto çaste. Donte të kthehej në sallon, por këmbët nuk po i bindeshin. Mendja dhe trupi sikur ishin larguar nga njëra-tjetra. Diçka gjë donte të bënte, por një forcë e padukshme e mbante aty.

Ndjeu një ledhatim të fillonte nga flokët e të vazhdonte të rrëshqiste ngadalë në faqe. Gishtat e tij

shëtितën mbi buzët që i digjeshin nga etja, kaluan mbi qafë, rrëshqitën lehtë mbi kraharor dhe u ndalën mbi bel. Zëri nanuritës që e shoqëronte këtë shëtitje mbi trupin e saj qe aq pranë veshit, sa Grejsa nuk dëgjonte vetëm fjalët, por ndiente avuj të ngrohtë të depërtonin brenda tij.

- E ku ka pikturë më të bukur se ty bukuroshja ime? Ja, përballë teje, ajo nuk duket asgjë. E di se është xheloze për ty! Për bukurinë tënde. Por i duhet të bindet se ti je më e mirë se ajo. Kërkon të shohë dhe diçka. S'e ndien? Ajo po të lutet. Do të shohë nëse lakuriqësia e saj i afrohet asaj tëndes.

Shikimi i trembur i Grejsës e bëri Ladin të ndalte udhëtimin me duar nëpër trup. E ndjeu atë t'i dilte nga pas, tek e kapi për beli dhe i vuri gishtat nën mjekër.

- E vëren shikimin e saj? Ia dëgjon mërmëritjet? Vetëm për pak çaste. Dhe ndërkohë, pa marrë asnjë miratim, pa i ndier lëvizjet e pakta kundërshtuese, duart e tij ndryshuan rrufeshëm ritmin, kaluan duke i hequr rripin e pantallonave dhe duke ia ulur rrëmbimthi ato.

Një skulpturë. Pantallonat në fund të këmbëve dhe duart e pafuqishme të lëshuara poshtë sikur donin të uleshin për t'i ngritur. Por nuk kuptonte se çfarë e pengonte.

- Oh ç'mrekulli! Ç'lëkurë! Krahasoje po të duash me mëndafshin. Dhe ajo po xhelozon për ty. Zëri i Ladit vinte çuditshëm dhe më shumë dukej si zgjatje

tingujsh që vinin të shkëputur nga njëri- tjetri. Tinguj garues për të sjellë fjalët, por nuk mundeshin. Dikujt i duhej të linte vrapin në mes.

Njomështia e buzëve të Ladit mbi të sajat dhe duar që lëviznin pa pushim mbi të. Endja e atyre duarve po përpiqeshin të preknin gjithçka nga trupi i Grejsës. Gjithçka që deri në ato çaste kishin qenë vetëm të sajat.

Shikimi po i turbullohej. Ndjeu që ishte ulur mbi shtrat dhe nuk po arrinte të kuptonte se si. Sytë po i mbylleshin me forcë. Gruaja përballë nudo qeshte me ironi me të dhe ndiente lëvizje duarsh.

Nuk e kuptoi se sa kohë ishte mbi atë shtrat, por sapo hapi sytë dhe pa veten lakuriq, u përpoq të tërhiqte cepin e çarçafit të hedhur në fund të shtratit. Një ndjenjë turpi i përfshiu vrullshëm të gjithë trupin. Nuk mbante mend asgjë. Ç'kishte ndodhur?!...

- Tamam si piktura! – dëgjoi nga pas një zë. U rrëqeth. Shikoi e trembur përreth dhe vetëm atëherë kuptoi se pranë saj krejt i zhveshur ishte ai.

- Vetëm se asaj i mungon engjëlli mbrojtës, - vazhdoi duke qeshur.

Grejsa nxitoi të mbështillej me çarçafin dhe të gjente rrobat e saj të hedhura andej-këndej.

- Të pëlqeu surpriza? Nuk të thashë se do të ishte e bukur?

Grejsa ndjeu frymëmarrjen t'i shpeshtohej. Pyetja se çfarë kishte ndodhur sorollatej si e çmendur në vorbullën e krijuar brenda saj.



- Përse ke turp? Nga unë?! Pastaj asgjë nuk mund të ndodhte pa dëshirën tënde!

Sytë e Grejsës dukeshin të zbrazët. Dridhja e duarve kur po përpiquej të vishej, sikur donin të fshihnin sa më parë diçka nga ajo. Dhe përballë buzëqeshja ironike e gruas në pikturë. Sytë nuk i bindeshin dhe e vështronin.

“Ç’donte t’i thoshte ajo grua?!” Ishte dëshmitarja e vetme e asaj që kishte ndodhur aty. Një dritë e zbehtë përpiquej të hynte dhunshëm përmes grilave. Vetëm në ato momente u kujtua për orën. Me këmbët që mezi i bindeshin nxitoi te dritarja, lëvizi pak grilën dhe një ndjenjë tmerri i mbuloi fytyrën menjëherë.

- Bobo! – vetëm kaq arriti të nxirrte.

- Mos u shqetëso! - sikur e kishte pritur këtë pashtrirmë Ladi i gjendur menjëherë pranë saj.

- Ti tashmë e di. Unë jam engjëlli yt mbrojtës.

- Më duhet të shkoj sa më shpejt në shtëpi! – zbehtësia, shoqëruesja e paftuar e fytyrës, që bërë aleate dhe me zërin e saj.

Nata kishte shtrirë dalëngadalë krahët në të gjithë qytetin. Hapat e Grejsës drejt shtëpisë ishin të ngathëta. Plogështia po e shoqëronte aq denjësisht, sa i vinte inat me këtë dinjitet të saj. Për një çast ngriti kokën për të lexuar si pa vetëdije reklamën përballë pallatit. Kjo reklamë rrinte gjithë ata muaj aty duke përsëritur të njëjtën gjë “Bëje vetë!”

Ç’budallallëqe! Por njëkohësisht kuptoi shkakun e plogështisë. Ajo nuk dinte se çfarë kishte ndodhur.

Turbullira e mbjellë diku në një cep, vazhdonte të qëndronte aty pa lëvizur. Kur u afrua pranë derës, u kujtua për porosinë e Ladit. Ah, ai! Ai kishte ndryshuar ritmin e rrahjeve të zemrës këta muaj. Ai përpiquej ta mbronte nga çdokush.

Ai! Nuk po e kuptonte se përse ky përemër zëvendësoi kaq papritur atë emër aq të dashur për të. Ende zëri i tij vazhdonte të rrëshqiste zvarrë mbi të gjithë trupin. Duart! Nuk po kujtonte qartë gjë dhe s'duhej të mendonte tani më.

Ndërkohë, në derë doli mami. Shikimi pyetës i saj e bëri Grejsën të recitonte porosinë e Ladit.

- Ah ma! Nuk të telefonova dot se e kishte të bllokuar telefonin Silva. Por nesër kemi provim në matematikë dhe ...

- Mirë, mirë! Më vjen mirë që mëson me Silvën. Por s'mund të më lesh pa lajmëruar.

“Si duket të gjithë sot duan të më surprizojnë!”, një ndjenjë habie iu bashkëngjiti gjendjes së Grejsës.

Në fytyrën e mamitë nuk gjeti gjurmë të zemërimit siç mendonte se do të gjente. Njëkohësisht, ndjenja e lehtësimit i veshi fytyrën duke i fshirë zbehtësinë që e kishte pushtuar ato orë. Shkoi në dhomën e saj. Mendoi të ndërrohej. Hoqi bluzën, pantallonat dhe si pavetëdije qëndroi para pasqyrës. Vizitoi me shikim të kujdesshëm linjat e trupit. “Duhet të jetë xheloze për mua? Ajo me atë trup aq perfekt?!”

Portreti i gruas nudo i qëndroi pranë për t'u krahasuar. Filloi të kalonte dorën mbi gjoks, bel dhe, ndërsa po vazhdonte shëtitjen në trupin e saj, një drithërimë i përshkoi trupin.

“Duar që lëviznin mbi trupin e saj.” I dukej si diçka e mjegullt. Nxitoi të merrte pizhamet, kur një zë nga pas i përshkoi drithërima më të forta.

- Nuk më fole kur erdhe! Dhe unë mezi prita sa të vije ti! Sa jam mërzitur sot!

I erdhi turp nga vetja. As e vuri re të motrën që gjatë gjithë kohës kishte qenë aty dhe me ndjenjën e habitës kishte parë veprimet e saj.

- Ja, sa të vishem dhe do të puth fort, fort për të shlyer gabimin e bërë.

- Po moj! Ti s'më do më mua! - e qara e së motrës e bëri të vetëdijshme Grejsën për sjelljen e saj këta muaj me të. Nuk i kishte kushtuar aspak kohë.

E qeshura nga dhoma e ndenjjes e kujtoi të pyeste të motrën se kush ishte në shtëpi.

- Është kushëriri i mamitë. Ka qenë gjithë pasditen këtu. Prandaj u mërzita më shumë se çdo ditë sot. Ti nuk ishe, ndërsa mamit i duhej të bënte muhabet gjithë kohës me kushëririn, - vazhdonte të ankohej e motra, ndërsa te Grejsa diçka u këput.

“Mami nuk qenka shqetësuar për mua, pasi nuk paska pasur kohë të mendonte. Ndoshta më mirë kështu, se kush do të duronte pastaj po t'ia niste me të sajat.”

- Thuajti mamit se jam e lodhur. Nuk dua darkë. Do të çohem herët nesër për të mësuar përsëri, - i foli

së motrës, ndërkohë ndjenja e fajit vazhdonte ta mundonte që po e linte motrën vetëm përsëri.

Por nuk donte të mendonte më për atë natë. I duhej të kridhej vetëm në një gjumë të thellë.

\* \* \*

Merit i dukej çudi për shpejtësinë me të cilën iu thartua ëmbëlsia e së përditshmes. Dilema nëse bëri mirë që takoi atë njeri, sillej zhurmshëm duke i mpirë gjymtyrët dhe mendjen. Nuk ishte në gjendje të kuptonte se çfarë po ndodhte. Ç'kërkonte nga ajo një njeri me atë pamje që mund të bënte për vete cilëndo vajzë?!

Përse pikërisht atë?!

Pastaj ndënji gjithë atë kohë për të kuptuar diçka dhe asgjë. Mjeshtëria e të folurit dhe shikimi i ethshëm sikur do të shkëputnin diçka nga ajo. Shkoi me mendimin se do t'i jepte fund trazimit të atyre zileve telefoni, por gjithçka ishte bërë më e ngatërruar se më parë. Nuk mund të mendonte më se ai ishte i papërgjegjshëm në atë që bënte, por si diçka e menduar më së miri.

Po Grejsa? Ndoshta do të ketë kuptuar diçka nga ai shqetësim i saj? Po djali me të cilin ishte e shoqëruar? Ç'lidhje do të ketë me të? Ç'budallaçkë! “Mos i duhej të bënte dhe mediokren tani?! Një mësuese plakaruqe që sapo sheh nxënësen të shoqërohet me një djalë dhe i duhet ta bëjë temë bisede!”

S'mund të ishte e tillë! Por..., sepse mbeti diçka e hidhur në momentin kur i pa të dilnin. Nuk e kuptonte

se pse ai djalë i la këtë shije në momentin e parë edhe pse vetëm për të qindtat e sekondës e vështroi.

“Sa i pabindur qenka mendimi!” Dhe pse nuk donte të mendonte në këtë mënyrë, një mendim i formuar aq nxitimthi s’donte që s’donte të shqitej.

“Njerëzit që gjykojnë vetëm nga ana e jashtme, janë pa karakter”, - sa e sa herë pati debatuar me shoqet në biseda të lira. Por, jo. Përshtypja e parë, do s’do, ulet diku e nuk pranon të lëvizë për një kohë të gjatë.

Ç’ironi!

E ndiente detyrim moral të kujdesej për nxënësit e saj në të gjitha mënyrat, por tani ndoshta duhej të mendonte më shumë për veten.

Si pa kuptuar, këmbët i morën rrugën e kundërt me atë të shtëpisë. Po e çonin te lokali ku shkonte shpesh me Petritin.

- Më mirë, - mendoi. – Duhet të sistemoj diçka në mendjen time para se të shkoj në shtëpi.

Nxitoi për në tavolinën ku ulej përherë, me pamje nga rruga. Gjithnjë i kishte pëlqyer gjallëria e qytetit. Çaji i kamomilit bashkë me erën që i përkëdheli fytyrën, i dhuruan disa momente qetësie.

Nxitoi të mbaronte çajin. I duhej të nxitonte. Ndoshta Petriti që në shtëpi. I kishte lënë një shënim mbi tavolinë se do të dilte për kafe. Asgjë më tepër.

Pagoi dhe, ndërsa po ngrihej, ndjeu mbi vete shikimin e paturpshëm të një zotërie të ulur përballë. Nënqeshja që iu ravijëzua në buzë i kujtoi “Emo poç!”,

grackën e shoqeve të dhomës në shkollë të mesme. E injoroi atë shikim duke ecur drejt. Kishte se për çfarë të shqetësohej.

Petritin e gjeti në shtëpi. Si gjithnjë me humorin në majë të gjuhës. “Kam qenë me fat, - rrëshqiti heshtazi te Meri mendimi.”

- Hë! Ç’kemi? Mirë?! Unë jam i vdekur sonte! Fushata, mirë që do fjalë e kohë, por dashka dhe këmbë. Fjalët e kohën i pata, por me këmbët...

- Përse?! Makinën pas vetes e ke pasur, - e ndërpreu Meri.

- Epo atje ku isha sot, mezi ngjitej gomari dhe jo më makina. Po shtrihem të shoh televizor në shtrat, pasi më dhembin kaq shumë këmbët sa...

- Mirë, mirë – më shumë u dëgjua një mermërimë nga ana e Merit. Nuk po kuptonte se përse po ndihej kështu. Priste Petritin ta pyeste se me kë doli për kafe, por ai asgjë. Ndoshta më mirë. Por gjithsesi nuk e kishte provuar më parë këtë ndjenjë.

Çfarë po ndodhte me të?!

Petriti as për djalin nuk u kujtua.

Nxitoi të hapte derën, pasi ndjeu të trokiturat e të birit të shoqëruara me një lumë fjalësh.

- Erdha zemër! Epo bëmë baba, të të ngjaj.

Moza po qeshte me gjithë shpirt. Qëndronte pas djalit, i cili iu hodh menjëherë në qafë duke iu ankuar se përse nuk kishte vajtur ta merrte te Moza.

- Shko te babi njëherë se e ka marrë malli për ty, - dhe me përkëdheljen nga pas sikur i dhuroi

shpejtësinë e erës. Menjëherë zëri i tyre mbushi të gjithë shtëpinë. Moza po e shikonte Merin me sy pyetës.

- Nuk qe pasdite e këndshme! Më mirë të mos shkoja fare!

Harku i formuar në vetullat e Mozës kërkonte të mësonte më tepër.

- Epo do s'do kanë mbetur tek unë disa gjurmë pyetjesh që, sado të mundohem t'i fshij, nuk i fshij dot, – dhe sytë e Merit qëndruan të pabindur mbi rrudhën e formuar në ballin e Mozës.

- Djali u kënaq. Luajti në kompjuter me mua, por çfarë shpirti ka se, do të arrijë patjetër fitoren, - nxitoi të fliste Moza, sikur nuk kishte dëgjuar asgjë nga fjalët e Merit. – Po iki tani se më presin. Natën e mirë!

- Natën!

Meri ndenji dhe disa çaste në derë derisa nuk i ndjeu më hapat e Mozës nëpër shkallë. Menjëherë më pas nxitoi në dhomë ku të dy po gajaseshin mbi shtrat. U shtri pranë tyre pa u ndërruar.

- Po mua, menduat të më linit vetëm?

- Jo, jo-të e djalit që filloi të hidhej mbi shtrat duke thirrur me të madhe, e bëri Merin ta kapte dhe të hidhte mbi të një breshëri puthjesh.

- Për sonte pica. Nuk po gatuaj.

- Unë nuk dua darkë. Dua vetëm të rri shtrirë.

- Epo mos ndërrosh mendje, se porosinë do ta bëj tani. Si duket të gjithë dashkemi të flemë herët sonte,  
- përfundoi Meri duke dalë e menduar nga dhoma.

Grejsa përpiquej t'i shmangej vazhdimisht Silvës. I pëlqente të ishte e çiltër me të, por një forcë e brendshme e ndalonte t'i tregonte për atë ditë. Diçka e shtynte larg, shumë larg. Mes ëndrrës dhe të përditshmes. Ëndrra ishte bashkuar aq shumë me të përditshmen sa nuk po arrinte t'i dallonte. Ishte pakufi e lumtur, por në këtë pakufi diçka e mundonte. Ndonjëherë e mundonte kaq shumë, sa ulej e pabindur mbi të dhe plogështia bëhej zot i mendimeve dhe trupit të saj.

Nuk i donte këto çaste pranë, por ato vinin të paftuara dhe me një epërsi të çuditshme e mundonin.

Ashtu e topitur ndjeu një dorë të butë mbi sup. Ktheu me përtesë kokën.

- Po ti? – toni i Silvës i shkundi njëherësh mendimet që i silleshin rrotull.

- Unë?!

- Jo, po Arbeni, - këtë radhë ironia e hedhur pa kujdes nga Silva e bëri Grejsën të ulej në bordurën e rrethimit të shkollës e të ngulte sytë mbi fytyrën e Silvës.

- Tërë këtë kohë më je shmangur. Mos të ka ngelur hatri prej meje?

- Jo, moj Silva, jo, - nxitoi Grejsa të largonte sa më parë dyshimet e Silvës. – Por as vetë nuk e di se çfarë po më ndodh.

- Mos je prishur me Ladin?

- Përkundrazi. Lidhja jonë është bërë më e fortë.



Është forcuar aq shumë sa fjala prishje nuk mund të ketë vend.

- Epo atëherë?

- Të të them të vërtetën, nuk e di ...! Nuk di se çfarë po më ndodh, por dëshira për të ndenjtur çdo minutë me Ladin është më e madhe se gjithçka.

- Grejsa! Ti ke bërë një zgjedhje. Uroj të kesh bërë të duhurën. Nuk do të doja të të shihja për asnjë çast të trishtuar, ashtu si nuk do të doja të ndikoja në zgjedhjen tënde. E di ti si dukesh kur je e gëzuar?!

- Si? – një rreze drite shkëlqeu në sytë e saj.

- Po ja, si të kesh marrë bukurinë e të gjitha luleve. E gjitha si të jesh e veshur me diell...

- Ou, dhe ti Silva! Po e tepron ca.

- Grejsa! Me të vërtetë nuk e shikon se ti nuk mund të kalosh në rrugë pa tërhequr vëmendjen e të gjithëve?!

- Mua më intereson të kem vetëm vëmendjen e Ladit dhe të askurrkujt tjetër. Po ti si i ke punët me babin?

- Shikimi dyshues nuk ka ikur, por fjalët e rënda po. Ndihem më mirë. Ndërsa mami nuk harron çdo ditë porositë.

- Më mirë ti me porositë e mamit, se me mamin tim unë.

- Përse?!

- Sepse është shumë më keq kur sheh se nuk merakoset kush për ty.

Silva dalloi në sytë e Grejsës trishtimin kur foli për të ëmën.

- Dhe ja vajzat e mia! – mësuese Meri me duart e hedhura supeve i afroi më pranë vetes. Ndonjë problem? – ndërkohë me sy hetues i vështroi të dyja.

- Asnjë! – nxitoi Grejsa të përgjigjej e para.

- Mirë, mirë! Kam punë se do të doja të rrija ca me ju. Gjithsesi, për çdo problem që të keni ejani e më takoni, ndërkohë shikimi i saj u ul mbi Grejsën.

- Mirupafshim vajza!

- Mirupafshim! – iu përgjigjën të lehtësuara.

- Më ka parë me Ladin në lokal, - theu heshtjen Grejsa.

- Po të kishte menduar keq, do të të thoshte. Ti e di si është zysh Meri.

- E di, e di. Po se si m'u duk atë ditë...

- Si?!

- Më mirë lëre fare. Nuk u ndjeva mirë kur e pashë, prandaj do të më jetë dukur e shqetësuar.

Pas bisedës me Silvën e mori veten, edhe pse i vinte keq se nuk u tregua krejt e sinqertë me të. Nuk i tregoi për gënjeshtren që i bëri mamit atë ditë kur i tha se mësonte te Silva.

A do ta pranonte më pas si shoqe po t'i tregonte të gjitha të fshehtat e asaj dite?! Kurrë?!

Në familje ajo e ndjente veten të ndrydhur. Sidomos nga i ati. Po mirësia në fjalët e saj ishte mëse e lexueshme.

Pas mësimit nxitoi të shkonte në shtëpi shpejt. Atletet e veshura bashkë me xhinset justifikonin

ritmin e fituar. Atë ditë nuk do ta takonte Ladin, pasi ai shkoi te hoteli në qytetin S. Dhe pse dy orët e fundit pati pushim, nuk doli me klasën. Donte të shkonte sa më parë në shtëpi.

E dinte se do të mbetej përpara kompjuterit ose para televizorit, por gjithsesi kishte shumë nevojë të ishte vetëm. Hapi derën. Sapo vuri këmbën brenda, të gjitha shqisat u vunë në lëvizje për të kuptuar diçka.

Këpucë të hedhura rrëmujë në korridor. Nuk qenë vetëm këpucët e mamit. Një palë këpucë burrash të kushtueshme, tregonin për praninë e dikujt tjetër në shtëpi.

Sapo donte të besonte përrallën e kushëririt të ardhur shpesh kohët e fundit, por një zhurmë nga dhoma e gjumit nuk i pëlqeu. Ç’duhej të bënte?

Nuk po kuptonte. Dilema rreth atyre zërave përpiqej ta shmangte nga një situatë e pakëndshme, apo po bënte të kundërtën?

Përse ndihej e shqetësuar?! Duhej të gjykonte ndokënd, qoftë dhe të ëmën? Mos ishte ndjenja e përkatësisë që po e mundonte? “Mami ishte e saja! Vetëm e saja! O zot, ç’mendoj kështu?”

- Po ti? Si hajdute hyn në shtëpi? – Toni i rreptë i mamitë që doli në korridor ashtu si nuk duhej të dilte, shkundi menjëherë mendimet garuese në mendjen e Grejsës. Nuk foli fare. Donte të thërriste fort, të mësonte se çfarë po ndodhte me mamin e saj, por vendosi të mbyllej në dhomë dhe të heshte.

Kush ishte ajo që të gjykonte të tjerët? Kush? Kjo pyetje do të endej gjatë në mendjen e saj për të marrë një përgjigje, por nuk do ta merrte dot.

Mami shfryu tërë inat në korridor për të, sepse hyri në shtëpinë e saj si “hajdute” dhe më pas një e përplasar dere.

Kjo e përplasar mbylli dhe një derë të rëndësishme në zemrën e Grejsës. As kjo derë nuk do të mund të hapej kurrë më për të ëmën, edhe kur do të kishte aq shumë nevojë për të.

\* \* \*

Fushata elektorale për Petritin po vazhdonte edhe më mirë se ç’e kishte parashikuar. Në çdo takim të bërë me elektoratin ishte pritur mjaft mirë. Rrjedhshmëria e të shprehurit ishte një armë e fortë në fushatë, pastaj besimi i njerëzve në ato që thoshte.

(Vetë nuk i besonte të gjitha premtimet!)

Ndonjëherë befasohej me pjesëmarrjen e gjithë atyre njerëzve në takime, të kënaqur me premtime e premtime të pafundme. “Epo ky popull nuk u ngopka me fjalë!”

Përparësitë nuk i mungonin. Pamja fizike dhe aftësia në të folur i shtonin pikë. E dinte mirë se përshtypja e parë te njerëzit ka shumë rëndësi. Edhe pse përdoren sa e sa fjalë të urta për mosvlerësimin e pamjes fizike, ai ishte mëse i bindur se mbi bazën e përshtypjes së parë që lë dikush, do s’do, i jepet ngjyrë

gjykimit të mëvonshëm. Dhe natyra ia kishte dhuruar që të dyja, pamjen dhe aftësinë e fjalës.

Ishte i rrethuar nga njerëz që e mbështesnin në çdo hap dhe, për më tepër, i shtronin përpara një tapet të kuq, kudo ku ecte. Ky tapet i kuq po i lehtësonte çdo vështirësi financiare. As që interesohej se nga vinin paratë, por po e jetonte momentin këndshëm, mjaft këndshëm. Po e jetonte në kuptimin e plotë të fjalës. Dhe kjo i pëlqente.

E vetmja që e bënte të ndihej keq ishte Meri. Ajo qe për të pasqyra e mirësisë, prandaj kishte frikë të shihej në atë pasqyrë.

Në të gjitha këto vite njohjeje nuk kishte ndodhur kurrë më parë. Epo ky ishte çmimi i pushtetit, i cili të vesh me disa mburoja të dukshme dhe të zhvesh heshtazi nga disa të tjera. Por duhej të dinte të vlerësonte situatën dhe të vazhdonte ecjen e tij për të treguar se dinte të fitonte.

Kështu atë natë përpiquej me çdo mënyrë t'i shmangej shikimit të Merit. Por a do të mundej gjatë kështu?!

Ishte i sigurt në forcën e së shoqes. Kjo forcë buronte që në shkollë të mesme ku Meri ishte “mollë e ndaluar” për të gjithë. Radha e admiruesve të saj qe e pafundme. Admirimi për të kishte lidhje jo vetëm me pamjen, por dhe me karakterin.

Lidhja e tyre kishte qenë krejt e natyrshme. Nga shoqëria e përditshme ishte kthyer në domosdoshmëri për t'u parë në çdo moment, për të jetuar bashkë çdo çast.

Çast! Ndjeu diçka t'i përshkonte akordet e zemrës. Akorde që, si rrymë elektrike, ishin përçarur vetëm nga prania e Merit. Tani drithëroheshin nga mendimi nëse ajo do të kuptonte atë që po ndodhte me të.

“Hajde burrë, hajde! Sido të vijë puna, burri lahet me një pikë ujë (këtë radhë fjala e urtë i shkante për shtat), ndërsa gruaja, jo! Atë nuk e lan dot një lumë i tërë.”

I vuri kapak këtyre mendimeve atë natë. Bindi veten se gjithçka ishte në rregull dhe iu kthye fjalëve përkëdhelëse të të birit.

Të nesërmen u ngrit herët. Do të shkante në lagjen “M”. Veshi kostumin gri dhe kollaren vishnje me vija. U pa me kujdes në pasqyrë. Vetja i pëlqeu.

- Mos e mundo veten, se bukur dukesh! - ndjeu zërin e Merit shumë pranë.

- Përse u ngrite kaq herët? Nuk je pushim sot?

- Epo nuk mund të fle pa të parë ty të veshur kur del. Si do të mendojnë të tjerët për kryetarin e ardhshëm në qoftë se çdo gjë nuk do të jetë në rregull? – dhe shikimi zhbirues i Merit shëtiti mbi Petritin.

- Njësoj mbete, - iu kthye ai duke e kapur për beli, – meraklie e fiksuar pas meje dhe tepër ndjellëse.

- Ashtu, ë! Ky po që është vlerësim, - dhe ia largoi duart nga beli.

- Po të bëj kafënë.

- Jo, jo. Do ta pi jashtë, - nxitoi Petriti duke u përpjekur t'i shmangej shikimit ngulmues të Merit.

- Mirë! - në këtë ton u ndie pakënaqësia për atë që sapo dëgjoi. – Po për drekë? Ku do të drekojmë sot?

- Përse?! – ndjenja e habitës veshi natyrshëm Petritin.

- Përse?! – bëri të habiturën Meri. – Harrove, zemër! Është e shtunë sot! A nuk më ke premtuar se do të drekonim jashtë?!...

- Ah, po, po. Kjo fushatë po më lodh tepër. Po më bën të harroj shumë gjëra.

- Mos vallë dhe ne futemi te gjërat e harruara?! Pastaj ne kemi shpirt dhe nuk jemi thjesht gjëra, - vazhdoi me ironi Meri.

- Mirë, mirë.

- Por dua ta di nëse më duhet ta përgatis drekën, apo jo.

- Meri, të lutem!... Mos i ironizo të gjitha tani. Thjesht kam humbur konceptin e kohës. Por, jo. Mos bëj gjë për drekë. Do të bëj çmos që kohën e drekës ta kem të lirë, - toni i Petritit dukej si toni i një adoleshenti të penduar.

Nxitoi të dilte. Hipi në makinë duke ndier mbi vete presionin e këtij mëngjesi. Nuk ishte përgatitur t'i bënte ballë asnjë debati me Merin. Nuk mund të harronte forcën që kishte ajo mbi të. U ndal para lokalit "A" dhe sapo zbriti dëgjoi nga pas:

- Hajde kryetar, hajde! Qysh në mëngjes herët je veshur gjithë shije. Si lumë elektorati për ty!...

- Mos u gëzo para kohe, se deri ditën e votimeve asgjëje nuk i dihet, - ia ktheu Petriti, i kënaqur nga besimi dhe lajkat i Zaimit.

- Ç'ne ore! Nuk shikon asgjë ti. Pastaj pa besim, mos iu fut një pune!

- Shpresa e bazuar mbi injorancë është më tepër ves sesa virtyt, - se si iu kujtua në ato çaste ajo thënie që kushedi se ku e kishte lexuar, ndaj vazhdoi. – Ajo mund të zgjatë përjetësisht, por pa dyshim edhe bie një ditë.

- Ore, ç'do të thuash me këtë? Sikur të dëgjojnë ata të kryesisë këtë “optimizëm tëndin”, nuk e kanë të vështirë të bëjnë zëvendësimin me një deklaratë të thjeshtë për mediat:

“Zoti Petrit L. për arsye shëndetësore u zëvendësua me kandidatin X”, - dhe duke i futur krahun hynë brenda në lokal.

Lokali ku sapo hynë ishte qendra e elektoratit të partisë së tyre. Shkurt, të gjithë simpatizantët dhe përkrahësit mblidheshin aty.

Ndërtimi i lokaleve në stilin modern dhe i eurolloteve ishte bërë një konkurrencë e fortë në qytet. Në çdo dhjetë metra do të njiheshe me një lokal të ri të veçantë dhe një eurolloto.

Tavolina e tyre ishte e rezervuar pranë dritares. Zaimi po vazhdonte përsëri me dyshimet e tij rreth asaj që sapo dëgjoji. Si duket donte të sigurohej mirë në ç'fakte dhe ide mbështetëj deklarata e Petritit thënë pak më parë.



- Ç'pikë ka kandidati tjetër përballë teje? Asnjë. Absolutisht asnjë. Ti je gjetja më e mirë nga ata të kryesisë. Pastaj, mos harro! Pikë të fortë ke dhe familjen. E kush nuk e respekton gruan tënde? Zonjë grua!

Shikimi i rreptë i Petritit e bëri Zaimin të mbaronte ligjërimin e nisur. Nuk e kuptoi se pse u krijua ajo ashpërsi te Petriti në momentin kur i përmendi të shoqen. A nuk kalohej në sitë të hollë e gjithë familja gjatë fushatave? Si duket te Petriti, megjithëse kishte vite në qytet, kishin mbetur ende disa mendimet prej fshatari ku femra duhej të rrinte vetëm në shtëpi dhe askush nuk duhej t'i përmendte apo të merrej me to.

Petriti vendosi të heshte.

Vetëm pas disa minutash, kur rrufti të gjithë kafen, foli:

- Po të ishte kandidimi im një shpresë e mbështetur në injorancë, kuptohet se nuk do të kandidoja. Nuk do doja të shënoja në asnjë mënyrë në civilë time një humbje. Humbjet nuk më pëlqejnë dhe nuk i pranoj. Kam hyrë në garë për të fituar dhe do ta arrij atë në çdo mënyrë.

- Kjo po! Ky është Petriti që njoh unë. Atëherë për fitoren! – e trokitura e gotave ishte aq e fortë sa klientët pranë nuk kthyen kokën për të mësuar diçka rreth asaj të trokiture.

- Ah, ja ku erdhi dhe Ladi, - foli Zaimi duke i bërë me dorë një djali që sapo hyri brenda.

Petritit iu duk fytyrë e parë dhe filloi ta hetonte nga larg. Kishte një ecje prej triumfuesi. I gjatë dhe i bëshëm. Shprehja e epërsisë i lexohej në fytyrë, gjë që s'mund ta fshihte. Ishte i bukur. Flokët e drejta të hedhura mbi ballë të krijonin përshtypjen e një aktori profesionist. Por Petritit nuk i krijua ndonjë ndjenjë simpatie për të.

Mbase nga shprehja e fytyrës.

- Është i yni, - nxittoi Zaimi t'i tregonte me zë të ulët duke kuptuar diçka nga vështrimi i Petritit.

- Dominues me sponsorët e fushatës.

- Ralf Mëler, - foli i sapoardhuri duke u ulur. - Aromatik, karizmatik dhe elegant.

Petriti picërroi sytë duke lënë të kuptohej se nuk po deshifronte asgjë.

- Eh, kryetar! Duket se nuk i kushtoni rëndësi markës së parfumit tuaj. Parfumi që keni hedhur të krijon jo vetëm ndjesinë e të qenit i fuqishëm e burrëror, por njëkohësisht dhe të njeriut të ngrohtë e sensual.

Petriti vazhdonte ta shihte me sy më hetues, duke ngrysur vetullat.

- Mos u habit Petrit, - sqaroi Zaimi. – Ladi merret me tregtimin e parfumeve luksoze. Ndaj njeh dhe di mirë karakteristikat e çdo parfumi.

- Më mirë thuaj që merret me tregtimin e gjithçkaje, - ndërhyri Ladi dhe i shkeli syrin Zaimit. – Nga një uiski kamerier për tavolinën tonë.

- Për mua asgjë, - nxittoi Petriti. – Më duhet të nisem.

- Jo kryetar, nuk mund të më fyesh në këtë mënyrë.  
Një gotë duhet ta pish me mua.

Petriti pa orën.

- Mos ki merak, në orën 11 do të jesh patjetër në vendin ku ke takimin. Gjatë kthimit drekën e kemi porositur. Gjithçka është në rregull. Aty ku do të drekojmë sot gatuhet mirë, - vazhdonte Ladi sikur të njihej prej kohësh me Petritin dhe jo se po takohej për herë të parë sot.

Petriti nuk foli më. Nuk harroi porosinë e Merit, por nuk kishte ç'të bënte. Meri duhej të ishte e ndërgjegjshme se fushata kishte të papritura. Pastaj nga Zaimi kuptoi se Ladi ishte një nga financuesit kryesorë të fushatës.

Do të takohej përsëri me Ladin në lokalin "F". Ishte me të vërtetë një mjedis çlodhës. Gjithçka ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që të kujtonte antikitetin. E habitshme se si kishin arritur të siguronin objekte aq të lashta.

Vera e servirur iu duk e ardhur nga një botë e largët për të rifreskuar çdo qelizë të trupit të tij. Sapo u ul, u kujtua t'i shkruante një mesazh Merit. "Të lutem më kupto, e dashur. Më doli një problem. Merr Mozën dhe djalin e shko diku për drekë. Të puth."

Pasi nisi mesazhin u qetësua. Tani i përkiste vetëm kësaj tavoline të madhe, ku vlerësimet për mënyrën e paraqitjes para elektoratit zotëruan gjatë gjithë kohës. Mbështetja e dhënë i jepte Petritit siguri për fitore.

Sytë, të pabindur, i rrëshqisnin te vajza përballë. Flokët e gjatë me kaçurrela të derdhura mbi supe kërkonin të shkriheshin me bardhësinë e lëkurës së saj. Përpiqej të gjente shëmbëllim me atë pamje kaq joshëse, por nuk po arrinte.

Pastaj sytë e saj të mëdhenj e me qerpikë të gjatë, që po e grishnin kaq shumë, uleshin e ngriheshin në mënyrë të tillë sikur vallëzonin me të qeshurat e tavolinës.

Gjithçka që ndodhi më pas ishte pjesë e “tapetit të kuq”. Do të freskohej në bardhësinë e lëkurës së asaj vajze, të cilës nuk arriti t’ia mësojë as emrin, do të luante me kaçurrelat e mrekullueshme dhe do të çlodhej nën ata qerpikë.

Kënaqësia që përjetoi atë pasdite ishte një mrekulli. Ai po shijonte suksesin në çdo kuptim të fjalës.

\* \* \*

Takimet e Grejsës me Ladin ndryshuan dukshëm. Koha që rrinin bashkë ishte shumë më e gjatë dhe pothuajse gjithnjë përfundonin në shtratin përballë fotos së gruas nudo në fotografi. Grejsa kishte shtypur me dhunë të gjitha ato ndjenja të fillimit ku dilema endej përvajtueshëm brenda saj.

Gjithçka po ndodhte i përkiste asaj dhe vetëm asaj. Që atë ditë nga ndodhia me mamën asgjë nuk i bënte më përshtypje. Babi nuk ishte bërë i gjallë plot tre vjet të plota. Më e mira ishte ta fshinte fare nga mendja.

Përse duhej të mendonte për të kur ai që e kishte sjellë në jetë, nuk kujtohej as ta merrte në telefon?

Në këtë gjendje që ndodhej, boshllëqet ia i plotësonte Ladi. Pija, shoqëruesja e dollive, i pëlqente aq shumë sa mezi priste ta shijonte. Ajo i dhuronte qetësi. Në ato çaste mendonte vetëm për vete. Lundronte me ëndrrat e saj dhe ndihej e lumtur, pafundësisht e lumtur. S'kishte pse të mendonte për ato që e rrethonin. Dhe pikërisht këtë donte Grejsa. Të arratisesh nga të gjithë.

Edhe pse në shtëpinë e Ladit filluan të vinin plot djem e vajza të tjerë, që shijonin së bashku pijen e magjishme, Grejsës nuk i bënte përshtypje. Secili shijonte lumturinë e tij në mënyrën e vet, pa limite.

E ndjente veten midis njerëzish. Miklimet në rrugë i jepnin një lloj ledhatimi të veçantë. Çudi! Më parë as i kishte vënë re. Po ndryshonte. E kuptonte. Vetëm para Silvës ndihej keq. Mendonte se kishte tradhtuar diçka në besimin dhe shikimin e saj. Po çfarë? Nuk arrinte ta imagjinonte.

Pastaj, si gozhdë i rrinte në mendje momenti ku Ladi donte të ftonte dhe Silvën në festat e tij. “Jo!” -ja e prerë e Grejsës e bindi të mos e përsëriste më këtë kërkesë.

Magjia nuk zgjat përgjithnjë. Dhe kjo magji u fashit.

Atë ditë Grejsa u zgjua nga shtrati në krahët e një mashkulli tjetër, pothuajse moshatar me Ladin. Sapo hapi sytë vuri re skërmitjen e dhëmbëve të tij.

- Me mua u tregove më e mirë. Epo jam mjeshtër unë!

Grejsa çakërriti sytë e lemerisur. Çfarë kishte ndodhur? Ku ishte Ladi? Në këtë shtrat ajo zgjohej vetëm me Ladin. Vuri dorën në gojë dhe e kafshoi fort, kur pa Ladin në fund të dhomës me një vajzë tjetër. Ndjeu dhembjen deri në palcë, por nuk donte ta shkëpuste dorën derisa një shuplakë e fortë iu ngjesh në fytyrë. Në këto çaste, Ladi u afrua.

- Çfarë ke Grejsa? Ti ishe dakord të luanim kështu! Tani po pendoresh? Ah, zemër, është vonë, jashtëzakonisht vonë për t'u kthyer pas. Të tre djemtë që shkuan me ty thanë se ishe e paparë. E pa-pa-rë! - theksoi fjalët e fundit duke i ndarë në rrokje më me forcë. Pranë u afruan dhe dy djem të tjerë.

Ç'po ndodhte? Po vazhdonin të luanin me të?! Në çfarë qe shndërruar kështu?!

Ndërsa po shqyente sytë nga tmerri, Ladi përballë po qeshte me të madhe.

Iu afrua pranë, i vuri dorën nën mjekër dhe duke i zmbarsur pak djemtë i foli në vesh:

- Po i tregove kujt për këtë ditë, atëherë do ta këtë radhën motra jote, pasi jot ëmë rri vetë në radhë. Nuk na duhet ajo plakaruqe kur ka dy vajza të mrekullueshme. Mos ki merak për tët motër se rritet shpejt. Pastaj..., mund të jetë edhe më e dobishme se ty.

Frymëmarrja e tij i binte mbi fytyrë. Ajo frymëmarrje nuk kishte asgjë të përbashkët me atë të disa muajve

më parë. Dora si darë mbante mjekrën e saj duke mos e lejuar të bënte qoftë lëvizjen më të vogël.

Iu duk një ëndërr e tmerrshme. Kapsalliti sytë për të vërtetuar se ishte me të vërtetë në ëndërr. Por, jo. Gjithçka që po jetonte, ishte e vërtetë.

- Dëgjo Grejsa! – këtë radhë toni ishte më i zbutur. – Duhet të jesh e përgjegjshme dhe asgjë e keqe nuk ka për të të ndodhur, as ty, as motrës tënde dhe, pse jo, as edhe ndonjë mikeje..., të cilën e ke përzemër. Do të argëtohesh dhe do të fitosh para.

- Pra ti thua të bëhem prostitutë!... Zëri i zvarritur i Grejsës mbante brenda tmerrin për atë që e priste.

- Prostitutë! – një e qeshur e fortë mbushi krejt dhomën. - Prostitutë apo... quaje çfarë të duash. Por nuk ke rrugë tjetër. Përse, çfarë ke bërë deri tani, kur ke fjetur me mua?

- Por, ti më doje? Kështu më do? – zvarritja e zërit të saj ishte vajtuese.

- Patjetër të dua, por më shumë dua paratë. Dhe shumë nga ato do t'i marr prej teje. Mos u merakos, do të ketë dhe për ty.

- ?????

- Po nuk u binde, nuk është problem. Bindim tët motër. Vlen qysh tani. Ka plot që japin shumë më tepër për t'u zbavitur me të mitura. Zgjedhjen bëje vetë, – buzëqeshja triumfuese sundoi fytyrën e Ladit.

Pati fituar. Në rrugën më të poshtër, por ia doli mbanë.

Një bubullimë e fortë u dëgjua jashtë. Dridhje të pandërprera i përshkruan Grejsës trupin. Nga bubullimat jashtë?!

Jo. Bubullima më të tmerrshme ishin fjalët e sapo dëgjuara. Dielli, që i kishte buzëqeshur këta muaj, ishte errësuar aq shpejt sa mblodhi të gjitha rrezet e tij dhe fshehu gjithçka. I largoi nga ajo. Dhe të mendosh që Grejsa i donte aq shumë ato rreze, sa i përqafoi me gjithë shpirt, i veshi në çdo qelizë të sajën, u dha zemrën. Ndërsa tani...

Shi i rrëmbyer filloi të binte jashtë. Dukej sikur ky shi po zbrazte tërbimin e reve për ato fjalë të tmerrshme që u dëgjuan. Pikat e shiut po i lagnin Grejsës trupin duke i shkaktuar mornica, edhe pse që brenda. Dridhja nuk po i ndalonte. Kjo ndodhte për shkak të zemërimit që nuk do të ndalej kurrë.

- Përse?! Përse?!

Bubullimat vazhdonin të gjëmonin më fort për t'i kujtuar tërbimin. Ndërkohë, frika dhe urrejtja u kapën fort përdore dhe vendosën të mos largoheshin kurrë nga ajo.

Frika për të motrën, atë krijesë të pafajshme që nuk i kishte bërë asgjë të keqe kësaj bote dhe urrejtja për këtë njeri, i cili deri në ato çaste kishte qenë dielli, ëndrra dhe shpresa. Ndërsa tani...

Tanimë, nuk ishte e sigurt as për veten se çfarë ishte.



Mungesat e Grejsës në shkollë çdo ditë sa vinin e bëheshin më të shumta. Një ditë Meri, e kënaqur kur arriti ta shihte në shkollë, e porositi që në pushim ta takonte pak. Një lëvizje e kokës në shenjë pohimi e Grejsës i mjaftoi asaj për ta pritur gjatë gjithë pushimit, por Grejsa nuk shkoi ta takonte.

Shqetësimi filloi të rritej më shumë. “Përse nuk erdhi Grejsa? Çfarë e mundonte atë vajzë? Qe mësuar të shihte lumturinë në sytë e saj të bukur, por këto mungesa që herë justifikoheshin me raport mjekësor dhe herë jo, kishin një domethënie. Po çfarë?!

Vendosi ta priste pas mësimit. Po rrinte në krye të shkallëve dhe sa ra zilja kërkoi me sy në mes të nxënësve Grejsën, por nuk e pa gjëkund.

- Silva! - i thirri vajzës kur po i kalonte pranë. – Ku është Grejsa?

- Kërkoi leje orën e fundit. Nuk e mora vesh se përse u largua.

Psherëtima e dalë nga Meri u bashkua me pyetjen në sytë e Silvës. Meri e afroi më pranë duke i lënë të kuptonte se donte të bisedonte me të.

- Eli, më prit të lutem, - porositi Elin, i cili po priste në fund të shkallëve.

- Silva, dua të di se çfarë po ndodh me Grejsën. Me mungesat e bëra ka mundësi të hyjë në nxënësit që nuk klasifikohen, - toni urdhërues i Merit shtoi dyshimin në sytë e Silvës.

- Silva, të lutem më kupto. Dua të ndihmoj Grejsën.

- Të them të vërtetën as unë nuk po kuptoj asgjë. Kohët e fundit, edhe kur vjen në shkollë, përpiqet të më qëndrojë sa më larg. Shpesh pyes veten nëse pa dashje mos e kam bërë t'i mbetet hatri. Jam përpjekur të mos i ndërhyj në lidhjen e krijuar. Pastaj më vinte mirë kur e shihja aq të lumtur. Gjithsesi, mendoj se dhe po t'i thosha ndonjë gjë, këshillë apo mendim, do të ma vinte veshin mua kur të gjithë mendojnë se i përkas një familjeje “fshatare”, pas asaj që ndodhi në fillim të shkollës?

- Ah, jo shpirt! Nuk duhet të mendosh kështu, - dhe e tërhoqi pas vetes me dorën e vënë mbi sup, – ti e di mirë se sa të duan. Në jetë herët a vonë do të ndeshesh me vështirësi nga më të ndryshmet. E rëndësishme është të dish t'i kapërcesh. Mirë, Silva. Shko se të vonova dhe mos të ikën autobusi. Faleminderit xhan!

- Mirupafshim!

Pyetjes së Elit se për çfarë bisedoi me mësuese Merin, Silva iu përgjigj krejt shkurt. Në mendje po bluante gjithçka që kishte të bënte me Grejsën kohët e fundit.

Ndërsa Meri po i vështronte nga lart. I ndoqi me sy nga dritarja e korridorit derisa kaluan portën e shkollës.

Rruga e Silvës po vazhdonte e sigurt për të mos u ndalur më. Bindja se do të vazhdonte shkollimin e plotë po forcohej gjithnjë e më shumë.

Tashmë, shqetësim mbetej Grejsa. Ç'po ndodhte me të? Mos ka ndikuar lidhja që kishte krijuar apo problemi mbetej te mamaja e saj?!.. I gjithë qyteti ziente nga thashethemet për të.

- Meri, do të vazhdosh të rrish ende? – dëgjoji ta thërrisnin nga pas.

- Vazhdoni, vazhdoni, se vij pas pak. Donte ta bënte rrugën e vetme me mendimet e saj. Ndryshimeve në sjelljen e Petritit ia linte ngarkesës së detyrës që po merrte. Nuk ishte e lehtë të drejtoje jetën e një qyteti, sado i vogël të qe ai! Kështu qe gatuar ajo!

Shqetësimet e nxënësve në shkollë i merrte me vete dhe në shtëpi. Ndërsa problemet e të shoqit po mbeteshin...

- Mirëdita profesoreshë! – nuk e kuptoi se nga mbiu ky burrë që i doli përpara duke i zgjatur dorën.

- Mirëdita! – sytë e Merit u takuan me atë shikim që prej muajsh e kishte fshirë nga kujtesa. Qe ai. Zotëria i telefonatave.

- Mund të pimë një kafe ju lutem!

Meri e pa me kujdes. Po, po. Qe ai. I vetmi ndryshim qe se po tregohej më “i qytetëruar” në komunikim.

- Jo, jo. Faleminderit! Po më pret im shoq për drekë, - foli duke i mëshuar më fort fjalëve të fundit.

- Dëgjo profesoreshë! Nuk mund të bëj lojëra fjalësh në rrugë, pasi e di mirë se si gruaja e kryetarit të sapoemëruar, keni mbi vete shikimet e të gjithëve. Të betohem! Nuk do ju shqetësoj kurrë më. Pastaj, sa

për kryetarin, po ha drekë si përherë në lokalin “D”.

Dhe pse kujtimi i atyre telefonatave dhe biseda që pati pasur me këtë tip qenë strukur të zbehta në një qoshe të mendjes, toni i zërit të këtij njeriu, të cilit nuk i dinte as emrin, iu duk i sinqertë.

\* \* \*

Koha e ndenjjes me njeriun e enigmave që e shkurtër. Të gjitha mëdyshjet e mëparshme me këtë njeri u fshinë si me një të klikuar të mausit. Ishte e vërtetë që kishin qenë në të njëjtën shkollë bashkë. Kishin qenë në të njëjtin konvikt dhe pse Meri nuk e mbante mend. Epo nuk mund të mbaheshin mend të gjithë konviktorët.

Një shqetësim tjetër po rriste këmbët brenda saj. Qëllimi i vërtetë i telefonatave, me të cilat kishte dashur të provokonte Merin.

- Të veprosh në mënyrë të tillë me një grua të martuar, duhet që ajo në një farë mënyre të të krijojë mundësi apo të tregojë se i pëlqen një lidhje tjetër. Po unë?! Kur mund të të kem lejuar për të menduar diçka të tillë?! Nuk të kam parë kurrë! Edhe po të të shihja, se njerëz të shumtë shohim çdo ditë, nuk do të kishe aspak rëndësi për mua, as ti dhe askurrkush në botë. More zotëri, jam e dashuruar me tim shoq! – fjalët e Merit ranë si breshër mbi të, jo vetëm duke i thumbuar trurin, por duke ia mbuluar edhe trupin me djersë të ftohta.

Ndihej fajtor.

- Më falni! Ishte diçka tjetër që më futi në këtë trill. Ju nuk e meritoni! Mos më kërkoni shpjegime të tjera. Thjesht mendoni se isha hije e një trilli. Ky trill nuk duhej të binte mbi ju. Ju lutem, më falni!

Ngulmimi i syve të Merit kërkonte më shumë shpjegim, por zotëria enigmatik (të cilit as emrin nuk ia mësoi) u ngrit dhe duke përshëndetur me dorë tha:

- Zoti është i madh. Herët a vonë fajtori i vërtetë do të marrë ndëshkimin e duhur, - dhe ishte larguar pa e lënë Merin të mësonte më tej.

Çfarë kishte dashur ai njeri? Mos qe bërë qendra e hakmarrjes? O zot! Si janë njerëzit kështu? Përse u duhej të hakmerreshin? Ndaj kujt? Mos kishte të bënte me zgjedhjet e Petritit? Pyetjet qenë shndërruar në përrenj të rrëmbyeshëm që nxitojnë për t'u derdhur në lumë. Në këtë lumë qenë zhytur thellë, tepër thellë mendimet e saj.

Patjetër, do të kenë të bëjnë me zgjedhjet. Do ta priste Petritin atë natë deri në orët e vona për të hedhur në këtë lumë pyetjesh dhe atë. Tashmë ishte e sigurt se aty do të gjente përgjigjen.

\* \* \*

Gërvishtja e derës, bëri që Meri të ngrihej rrëmbimthi nga divani. Sytë i rrëshqitën te ora. Ishte shumë vonë. Kryqëzoi krahët para dhe u mbështet te parmaku i salloni. Shoqëronte me sy lëvizjet e Petritit.

Këto lëvizje nuk iu dukën të zakonshme. Mungonte gjallëria pas së cilës ajo qe dashuruar.

- Probleme? – e pyeti duke u përpjekur të takonte sytë e tij.

(Heshtje). U ul në divanin përballë, shtriu këmbët dhe mezi foli.

- Jam shumë i lodhur!

- Të prita, Petrit. Doja të bisedoja me ty.

- Ah të lutem, jo sonte! – në zërin e tij ndihej më shumë urdhër se sa lutje. – Vetëm dua të shtrihem.

- Mirë, mirë, - mërmëriti Meri, - por ama nesër në mëngjes duhet të gjesh kohën patjetër për të biseduar. Është shumë e rëndësishme për mua.

Pasi u shtrinë në shtrat, nuk u desh shumë për të dëgjuar gërhimat e Petritit. Këto gërhima do të shoqëronin Merin në errësirë.

“Mendimet vallëzonin në atë gërhimë lodhjeje.” Tani i kujtoheshin fjalët e nënës së saj, kur nuk flinte natën, se sa e mundimshme ishte të rrije zgjuar. Po bindej në vërtetësinë e tyre, pasi bindja forcohet vetëm kur ti e ndijon ose e provon vetë.

Mendimet merrnin ngjyrën e natës dhe shqetësimi brenda saj sa vinte e rritej. Shumë vonë mezi arriti të flinte, por në mëngjes ndjeu një dorë mbi vete që përpiquej ta shkundte nga ai gjumë i lodhshëm e i mundimshëm.

- Meri! Do të iki se kam punë.

- Ah, ja se u ngrita. Mos ik!

U ngrit duke u përpjekur të kthjellonte mendimet.

- Pata një problem gjatë kësaj periudhe.

Petriti ngrysi vetullat, ndërkohë Meri ndaloi rrëfimin dhe uli ngeshëm shikimin mbi të.

- Mbrëmë nuk kam fjetur fare, - vazhdoi me qetësi.  
- Më mundoi mendimi se dikush donte të hakmerrej me ty, me mua, kushedi...

- Të hakmerrej?! Përse? Hajde Meri, hajde, kush e di se çfarë ëndrrash paske parë mbrëmë!

Meri u ngrit nga shtrati, i doli përballë duke mos ia ndarë për asnjë çast shikimin. Donte të kuptonte më shumë brenda atij shikimi. Një buzëqeshje u lexua mbi fytyrën e Petritit.

- Meri, ti e di se sa ngarkesë kam. Sot më duhet të pres një organizatë joqeveritare që vjen nga Roma. Po interesohem për të bërë një bashkëpunim me ta për sistemimin e...

- Nuk të kam ndërhyrë në punën tënde, sepse e kam kuptuar se nuk e ke dashur këtë. Ke arritur të më bindësh se të jesh kryetar Bashkie do të thotë t'i mbash problemet e punës për vete, - ironizoi Meri. - Por të mos shqetësohesh kur unë të them se më ka munduar një problem kaq shumë sa nuk kam vënë gjumë në sy, më duket absurditet.

Heshtje. Petriti përpiqet t'i shmanget shikimit të Merit, duke rregulluar kollaren para pasqyrës, ndërsa Meri i rri nga pas si truproje.

- Absurditet më duket të flitet për hakmarrje. Ajo s'ka të bëjë me ne. Përse, si mendon ti se gjithnjë duhet të hakmerren ndaj njerëzve që kanë një pozitë?

- Atëherë, i dashur burrë, të lutem ulu e më dëgjo. Të shohim nëse do të ndërrosh mendim pas kësaj, - mori frymë thellë dhe vazhdoi.

- Dikush u përpoq të flirtonte me mua. E kupton se çfarë po të them, pasi përdora shprehjen e përdorur nga të rinjtë sot.

- E di se çfarë po flet?! - një ngjyrë e errët i veshi fytyrën rrëmbimthi.

- Të lutem më dëgjo deri në fund. Personi i cili tentoi të më ngacmojë nuk donte të krijonte një lidhje me mua. Ai donte të hakmerrej ndaj teje. Unë në këtë rast isha thjesht guri me të cilin donte të luante, - vazhdoi Meri e sigurt në fjalët e saj.

- Deri ku arrite ti?! – toni i Petritit tashmë ndryshoi 100% formë dhe ngjyrë. Sytë iu shndërruan në dy rrrathë të vegjël që përcillnin jo vetëm tërbim, por diçka më tepër, shumë më tepër.

- Ta kam bërë të qartë dhe më parë, - toni i prerë i Merit ngriu veprimet e Petritit. Nuk po luante më me kollaren. – Faqen e bardhë e ruaj në radhë të parë për vete. Ti e di mirë se kur një njeri nuk di të vlerësojë veten, nuk ka si të vlerësojë të tjerët, qoftë dhe burrin.

- Mirë, mirë. Të njoh, por mund të më tregosh më shkoqur si është kjo puna e hakmarrjes, se nuk po marr vesh asgjë.

Meri i tregoi për bisedën me njeriun enigmatik, duke shmangur një pjesë goxha të madhe të shqetësimit që kishte kaluar. Reagimi i Petritit bëri



që gjërat t'ia thoshte sa më shkurt. Pas disa minutash ai tha:

- Epo ka njerëz të çuditshëm plot! Duhet të rrish e qetë se nuk i kam bërë keq kujt për të kaluar një situatë të tillë. Detyra do, s'do mund të të detyrojë të shkelësh në kallo ndokënd. Jo të gjithë tregohen korrektë me ligjet, por... Megjithatë, nuk duhet të shqetësohesh për këtë. Rri e qetë, se askush nuk guxon të na cenojë. Tani po iki. Më duhet të mbaroj disa punë para se të pres përfaqësuesit nga Roma. Pafshim!

U kujdes për fjalët e tij. Duhej të ishte sa më bindës, por ndërkohë shqetësimi zbriti e iu ul brenda rëndë-rëndë. Kush donte ta poshtëronte në një mënyrë të tillë?

Mos ka cenuar dikë? Nuk mund të hakmerreshin kaq lehtë në këtë formë. Gjithsesi, duhej të tregohej i kujdesshëm ose më mirë të hiqte dorë nga kjo mënyrë e të zbaviturit këto kohë. Askush, për asnjë arsye nuk duhej të arrinte deri te familja. Ajo ishte pjesa më e shëndetshme, që e plotësonte në çdo drejtim.

Ndërsa tek ai vetë virtyti dhe morali, të cilat dikur i pati mburoja të forta, tani qenë zbehur. “Duhej të jetonte çdo ditë si të qe e fundit për të!” – kështu këshillonte dhe Buscalia. Atëherë për çfarë i duheshin ato mburoja?!

Dreqi t'i hajë! Por duhej të ishte i kujdesshëm. Ky mendim s'i shqitej nga vetja...

Rrezet e diellit po hynin me përtesë nga dritaret e hotelit. Grilat e ngritura lart kishin qenë dëshmitare të heshtura të këtyre netëve. Hëna tinëzare me kureshtjen e saj kishte depërtuar përtej dritareve dhe kushedi se si ndihej në këto çaste, ashtu e fshehur diku ku vetëm gjurma e zbehtë qëndronte lart.

Kushedi! Do të mbetj enigme. Sepse kështu qe gatuar ajo. Enigmatike deri në fund. Me dritën e zbehtë duket se do të të vërë në një gjumë të rehatshëm, por në anën tjetër, si tinëzare, shtrin me qindra tentakula për të parë e dëgjuar se çfarë bëhet nën petkun e natës.

Ndërsa tani... Tani Grejsës, ngjyra transparente e hënës, i dukej si gjurmë e një vaji të dhimbshëm.

“Do të ketë qarë vallë ajo për mua?!”

Mbuloi kokën me çarçaf duke shtrënguar sytë fort për të fshirë gjithçka i kishte ndodhur në këtë hotel të mallkuar.

Dëgjoi gërvishtjen e derës të rrëshqiste mbi të. Shtrëngoi çarçafin më fort.

Një lëvizje e shpejtë ia tërhoqi atë me rrëmbim poshtë. Nuk bëri përpjekje për t'u mbuluar. Sytë e saj të egërsuar takuan shikimin shpërfillës të Ladit. Ai po hetonte gjithçka të sajën nga majat e flokëve deri te këmbët. Me një lëvizje të kokës, vetëm sa pohoi:

- Mbetesh mirë!... Më e mira!

Ajo po rrinte si e ngrirë. Priste në rrëmujën e ankthit se çfarë do të ndodhte më tej. Por asgjë. Çarçafi iu hodh përsëri sipër. Iu duk ky çarçaf në këto çaste si mburojë e magjishme.

- Fli! Je me të vërtetë më e mira! – ripohoi dhe një herë ato që sapo tha pak më parë dhe u largua duke lënë pas kuisjen e derës tek mbyllej zhurmshëm dhe njëkohësisht atë të shpirtit të Grejsës.

Shtrëngoi përsëri çarçafin fort pas vetes duke pasur frikë se mos largohej magjia e saj në këto çaste.

E habitshme!

Si është jeta! Një çarçaf hoteli po bëhej i magjishëm.

Në këto çaste kaq magji kishte për Grejsën. Mbështjellja me të do të thoshte siguri, larg syve të babëzitur të klientëve e duarve të hekurta të tyre. Çdo prekje për të që një shufër hekuri që përplasej dhunshëm mbi butësinë e trupit të saj.

Atij trupi, linjat e të cilit sa e sa herë i kishte adhuruar para pasqyrës. Tanimë i mungonte guximi për ta parë aty, sepse pasqyra nuk do të ngurronte t'ia përplaste me neveri para syve ato skena që nuk donte t'i shihte më.

U mblodh kruspull mbi shtrat. Ndihej si një larvë. Po. Në të tillë që shndërruar.

Një shkëndijë tmerri lindi rrufeshëm. Përse Ladi u soll në atë mënyrë qëparë? Çfarë ka kurdisur për më tej ai?

Po kalonte pothuajse një vit dhe fjalë të tilla qetësuese nuk pati dëgjuar në zërin e tij. E ç'mund të bënte më shumë se kaq?!

Pas përpjekjesh të lodhshme e të mundimshme arriti më në fund të flinte. Përgjumshëm ndjeu derën të hapëj e të mbyllej, por asnjë zhurmë më tej.

Pasdite ndjeu nxehtësinë e diellit t'i futej poshtë çarçafit mbi trupin e saj lakuriq. Rrezet e diellit lëpinin në heshtje me endje lëkurën e butë.

U shtriq. Në këtë çast ndjeu gishtërinjtë e duarve të çliroheshin. Gjatë gjithë kohës gishtërinjtë mbanin me forcë atë mburojë të rreme. Frika se mos ia rrëmbenin çarçafin kishte mpirë duart aq fort, sa duheshin minuta të tëra për të mos ndier dhembjen e tyre.

Mezi hapi sytë për t'u orientuar se ku ishte. Pas disa minutash u bind se ora do të ishte tre ose katër, pasi në këtë orë rrezet e diellit përqafonin dhomën ku rrinte ajo.

U ngrit me përtesë duke u mbështjellë me çarçaf. Mbi tavolinë një tabaka me ushqimin e drekës priste ngeshëm. Por këmbët e çuan drejt tualetit. Hapi ujin e nxehtë aq sa i përvëlonte lëkura. Qëndroi si e shushatur poshtë dushit duke ndier mbi vete currilat e ujit të binin me zemërim mbi të. Qëndroi derisa i nxehti i përskuqi trupin. Mbylli me përtesë dushin duke u mbështjellë me peshqir.

Pas disa minutash u vesh dhe u ul pranë tryezës. Hante me nge duke përtypur dalëngadalë çdo kafshatë. Vështrimi, ndërkohë, udhëtonte larg, shumë larg në horizont, në shtëpinë e reve te bardha.

I pëlqente të luante me to. Për muaj me radhë qenë shoqërueset më besnike të saj. Mëngjeseve të vetmuara bisedonte nëpërmjet syve. Aty takoi motrën të mërzitur sepse mbeti vetëm, pa përkujdesjen e saj që e donte aq shumë.

E përqafonte dhe i dërgonte të puthurat nga larg, dhe pse që e sigurt se nuk mund t'i merrte.

Diku,... diku më tej që Silva e ulur në bankat e shkollës tek përgatitej për të shkuar në universitet. Flokët e gjata që i mbulonin shpatullat e drejta, dikur shumë të brishta, i jepnin siguri në rrugën e saj.

Më tutje, re të cilat formonin gjarpërinj dhe kafshë të lemerishme. Hoqi sytë që andej me rrëmbim.

Gërvishtja e derës i rrëqethi trupin. Nuk e ktheu kokën për të parë se kush që. Më mirë të mos dinte asgjë. Duar që u ulën mbi shpatullat e saj e filluan lëvizje harmonike rreth tyre. Nuk lëvizi. Asgjë nuk i bënte më përshtypje.

- Ah aroma jote! – një frymëmarrje e thellë pas vetes.

Qe Ladi. Ia dallonte zërin mes qindra zërash të tjerë, veçanërisht në atë qetësi ku vetëm përplasja e lugës dhe mbllaçitjet e saj dëgjoheshin.

- Askush nuk mund të bëjë indiferentën me mua! More vesh?! – e bërtitura e papritur e tij, u shoqërua me gishtat poshtë mjekrës. Gati-gati sa nuk i mbeti ushqimi në fyt.

Një pus i errët gëlonte në sytë e tij. Njëherësh ia hoqi gishtat nga mjekra dhe i rrëshqiti mbi gjoks.

- Sot dhe nesër pushim. Pushim absolut. Vetëm dush, ushqim dhe gjumë. Dua të ndihesh si e virgjër. Më kuptove çfarë dua të të them?!

Heshtje.

- Po dite të sillesh do të fitosh. Përndryshe!...

Nga ana tjetër përsëri heshtje.

- Mirë, më mirë ndoshta që hesht, sepse dhe zëri yt duhet të jetë i pastër. I pastër si kristali. Më pas, kur të erret, do të vij të të marr për shëtitje.

Grejsa e ndiente turfullimin brenda Ladit, por nuk kuptonte arsyen se pse po përmbahej. Shtirja për mirësinë e tij që e frikshme për të, pasi mirësia për Grejsën që fshirë njëherë e mirë.

\* \* \*

Emocionet e provimeve mbërthyen të gjithë. Kështu ndodhte në qytetin e tyre. Gjithçka e përjetonin bashkë. Rrugët, ndërtesat dhe vetë ajri që e përshkonte atë mbanin mbi supe ngarkesën e provimeve të maturantëve.

Jo shumë larg shkollës, i ulur i vetëm në një tavolinë, tymoste pa pushim cigaret një pas një Mark T. Tymi i duhanit që shqyente ajrin duke gjarpëruar, bënte të njëjtën gjë dhe në trurin e tij. Ndërsa sytë të pabindur udhëtonin larg, shumë larg, duke përçarur shikimin për të kapur diçka.

Nuk po kuptonte se çfarë po ndodhte me të. Epo nuk thonë kot se koha si tinëzare punon për të të

ndryshuar jo vetëm pamjen, por dhe mendimet. Herë të puth me dashuri e herë të flak tutje si një send pa vlerë. Ndonjëherë dredharake hyn brenda teje dhe t'i bën lëmsh të gjitha.

Eh, sa herë qe ngatërruar Marku me kohën dhe njerëzit që rrugëtonin bashkë! Koha pati luajtur ashpër, ndërsa tani...

Nga porta e shkollës filluan të dilnin maturantët e parë. Disa të skuqur në fytyrë, me stilolapsa e lapsa në duar, me zërat e tyre çanin qetësinë që pati pllakosur në ato orë rrugët e qytetit. Prindërit tërë emocione afroheshin, pyesnin, dikush përqafonte fëmijën e tij, dikush ulte kokën për të dëgjuar me vëmendje dhe në fund maturantët mblihdeshin grupe-grupe duke biseduar me zë të lartë. Sytë e Markut rrinin të ngulur te dera. Vetëm pas disa minutash e dalloi Silvën. E pa kur u bashkua me një grup nxënësish, të cilët, sapo doli ajo, iu afruan si me komandë. Arriti të dallonte nga larg dy djem dhe një vajzë.

Menjëherë u ngrit. La lekët mbi tryezë dhe iu afrua grupit me hapa të shpejtë. Ndiante hapat t'i rëndoheshin dhe, sado përpiquej të shpejtonte, i dukej se po numëronte në vend. U afrua aq pranë sa mund t'i prekte me dorë, por ata bisedonin pa e vënë re praninë e tij.

Nuk u foli. Qëndroi aty pa lëvizur. Me sy e veshë u përpoq të shkëpuste diçka nga biseda e tyre. Silva u përgjigjej pyetjeve se si i kishte dalë ky apo ai ushtrim.

Ndërsa njëri pohoi për përfundimin, tjetri i ra ballit me dorë duke thënë “bobo, i humba pikët këtu!”

Marku u kollit lehtë sa për të tërhequr vëmendjen e tyre, pasi e ndjeu veten keq të vazhdonte të përgjonte bisedën në atë mënyrë.

Silva e pa menjëherë dhe me zë të mbytur i foli:

- Po ti babi?

- Erdha për ty. Meqë pata punë këndeje, thashë të të pres.

- Mirupafshim! – iu drejtua Silva grupit me të cilët po bisedonte, ndërsa shikimet e tyre po i ndiqnin atë e bijë tërë ankth.

- Po më pyesnin për provimin, - u shfajësua Silva me frikën se çfarë mund të mendonte i ati në ato çaste.

- Mirë! Mirë! – dhe asgjë më tepër.

Vazhduan rrugën pa folur.

“Nuk duhet të ndihesh kështu! Ti nuk ke bërë faj!”, mendimet tekanjoze dhe të vendosura përpiqeshin të bënin më harmonike hapat e Silvës. Zbritën nga fugoni dhe ende asnjë fjalë. Sapo hynë në oborr Marku u kthye me një lëvizje të ngadaltë dhe pa e parë Silvën në sy i tha:

- I bërë të gjitha?

E hutuar për interesimin e papritur të të atit, Silva vetëm sa pohoi me kokë.

- Besoj se e ke zgjedhur degën për të lartën, - megjithëse fjalët i dolën zvarrë, si t’i tërhiqte dikush me vështirësi, te Silva patën efekt të magjishëm. Një aureolë e zbukuruar me perla i mbuloi fytyrën. Iu hodh



të atit në qafë duke e shtrënguar fort. Mos ishte në ëndërr?! Oh, jo! Hapi sytë aq fort për t'u siguruar se qe zgjuar.

- Vërtet babi?! – zëri ishte veshur me shumë emocion.

- Mjaft tani, se nuk je e vogël. Mendo të zgjedhësh degën e duhur për shkollën e lartë. Duhet menduar mirë se... , - por Silva nuk qe aty. Nuk iu deshën vetëm disa sekonda për t'u ulur përballë ikonës së Krishtit dhe po i fliste me zë:

- Faleminderit Jezu Krisht! Faleminderit! Faleminderit!

E ëma, nga pas, dëgjoji të bijën tek po falënderonte Jezusin dhe e qetë largohet për të mbaruar punën e lënë përgjysmë.

Të gjithë atë natë qenë veshur me gëzimin e Silvës. Vonë, kur do të shtrihej në shtrat, Silva do të kujtohej dhe për Grejsën. Do të donte t'ia jepte lajmin e gëzuar asaj dhe mësuese Merit të parave.

Po ku ishte Grejsa tani? Plot një vit qe larguar. Edhe pas denoncimit të së ëmës në polici e thashethemeve të shumta që zjenë në qyteti, vetëm heshtje. Një heshtje e gjatë ku asgjë nuk fliste më për Grejsën. Sikur të mos kishte ekzistuar. Silva në shtëpi e pati përjetuar në heshtje shqetësimin për Grejsën. Nuk mundi ta diskutonte as me mamin.

“Uroj të jesh mirë Grejsa, kudo që të ndodhesh!”. Me këtë urim fjeti atë natë duke lodruar dhe në gjumë me dëshirën e madhe për të vazhduar shkollën e lartë.

Kaluan më shumë se dy ditë të qeta për Grejsën. Përkujdesja e Ladit për të i dhuroi harmoni në pamjen e saj. Megjithëse dilte rrallë, ndiente mbi vete përsëri miklimet e kalimtarëve. Këto miklime i vuri re dhe Ladi, ndaj krekosej më tepër. Nuk ishte pak të shoqërohej me vajzën më të bukur të sezonit veror!

Shpresa se po ndryshonte diçka te Ladi sa vinte e rritej gjithnjë e më tepër. “Ndoshta Ladi po bindet se unë mbetem dashuria e tij e vetme dhe nuk do të më ndajë më me të tjerët!” Megjithëse tek ajo nuk mund të flitej më për dashuri ndaj këtij njeriu. Gjithsesi, do të qe më mirë për të që të duronte një kafshë se sa shumë e shumë të tjerë. Shikimi i Ladit e përpinte nga koka te këmbët, thua se e shihte për herë të parë. Fustanet që vishte tani kishin finesë dhe klasë. Nën to Grejsa dukej si perëndeshë e cila zotëronte gjithçka; qiellin dhe tokën, detin dhe ajrin. Mes gëzimit dhe zhgënjimit, ngadhënjimit dhe dhimbjes, shpesh fitonte zhgënjimi dhe dhimbja. Të dyja të kapura përdore grisnin pa mëshirë gëzimin. Atëherë Grejsën e mbulonte një perde gri që fshihte vrullshëm gjithçka. Asgjë nuk mund të lexohej aty.

Ladi, i vetëdijshëm për efektin e ndjenjave në pamjen e Grejsës, po bënte ç’të mundej që ajo të ndihej mirë.

Epo e meritonte!

Meri përgatiti gjithçka në kohën e duhur për pushimet e verës. Nisja për në qytetin S me Petritin dhe të birin që si një dhuratë pas asaj ngarkese të kaluar këto dy vite.

- Më në fund! – tha Meri sapo u ul në sediljen e makinës.

- Më në fund çfarë? – pyetja e Petritit që e sinqertë.

- Më në fund po lëmë pas problemet e një qyteti dhe po shijojmë disa ditë vetëm për vetëm! – theksoi jo pa qëllim fjalët e fundit.

- Çdo mbrëmje vetëm kemi qenë.

- Vetëm, por shumë larg. Po ta dija më parë nuk do të ta miratoja kandidaturën për kryetar.

- Po, tani po. Ke folur si fëmijë. Po pushteti, paraja dhe luksi?

Meri u kthye vrullshëm nga Petriti.

- Të vërteta janë këto që thua?!

- Dëgjo Meri! Nuk mund të mohosh favorët që të jep e një detyre. Respekt, vlerësime, privilegje...

- Këto nuk më kanë interesuar kurrë. Më intereson respekti, vlerësimi dhe dashuria që gjej në radhë të parë te ti. Sa për të tjerat e di fare mirë se sa respekt gjen. Por ti nuk shikon më tej. Nuk bën dallimin e hipokrizisë të disave dhe respektit të vërtetë. Pastaj, sa për luksin, s'më ka interesuar ndonjëherë.

- Më duket se tani po bën hipokriten.

- Jo, të them të vërtetën. Por nuk kuptoj se çfarë po ndodh me ty. Ku janë parimet e tua për ta dashur tjetrin për atë që është dhe jo për atë që vesh, qoftë ky çdo lloj pushteti, - Meri ishte skuqur në fytyrë tek fliste.

- Mami dhe për pushime do të grindeni? – fjalët e djalit thithën shikimet e të dyve. Për disa çaste heshtje.

- Zemër, - iu drejtua Meri djalit pas pak, - të rriturit diskutojnë për gjëra të rëndësishme që kërkojnë ndonjëherë të ngrenë ose të ulin zërin. Kjo nuk quhet grindje.

- Pse, janë grindur ndonjëherë prindërit e tu? – i foli Petriti duke i shkelur syrin.

- Kurrë!

Prugën e bënë të heshtur. Dëgjohej vetëm Meri që i tregonte djalit herë pas here për vendet ku kalonin, duke dashur t'i mbetej në kujtesë diçka nga ai udhëtim.

Në orën 6, qenë pranë hotelit që kishin rezervuar. Ai mbante lart plot krenari pesë yje.

Meri vështronte jo pa kureshtje ndërtesën. E lartë, me një arkitekturë krejt të veçantë dhe harmonizim ngjyrash.

- E sheh grua! Hotel me pesë yje! Jo gjithkush mund të ketë privilegjin të pushojë këtu! – Nuk i pëlqeu fare krekosja e Petritit, por nuk foli.

Nxitoi të merrte një valixhe dhe të vazhdonte të ecte.

- Ah, jo e dashur, jo. Kot nuk kemi ardhur në hotel me pesë yje. Ti asgjë nuk do të mbash në dorë. Të gjitha t'i sjellin në dhomë.

Në dhomë nuk u end për të parë mjedisin ku do të kalonin këto ditë pushimesh. I mjaftoi ballkoni me pamje nga deti, ndaj menjëherë u shtri në shtrat e lodhur. Pranë iu hodh djali duke e përqaftuar fort.

- Më vonë do të dalim, ë! Nuk mund ta humbasim një natë.

- Mirë, por të pushojmë pak, pastaj.

- Unë po dal pak.

- Babi, po vij me ty – dhe nuk vonoi ta kapte përdore.

Vetëm pas një ore Meri e ndjeu veten krejt mirë. Rregulloi plaçkat, bëri dush dhe u vesh. Kur u kthyen Petriti me djalin, ishte gati.

- Tamam si pranverë! – qeshi Petriti kur e pa. – Si duket yjet e hotelit janë ulur të pushojnë me ty.

- Si përherë, s'kam bërë ndonjë ndryshim. Por, po më pëlqejnë lavdërimet e tua.

Freskia e mbrëmjes lundronte atë natë te të tre duke fshirë çdo gjurmë të fjalëve. Vonë ranë për të fjetur, me merakun se ajo që lanë jashtë ishte qetësia e dëshiruar prej kohësh.

Petritin e zuri gjumi menjëherë sapo u shtrinë. “Epo donte të dilte sa erdhi!”, e justifikoi Meri, ndërsa vetë u dha në ballkon. Qyteti dukej i magjishëm nën efektin e dritave të shumta. Dritat pasqyroheshin

bregut të detit, kurse valët përpiqeshin të merrnin ndriçimin e tyre me vete ose luanin se kush të kapte më shumë ndriçime.

Qeshi me vete. Iu kujtua Remarku “*me valën dhe shkëmbin*”. Valë lozonjare dhe dredharake!

Nuk dinte se sa kohë ndenji duke parë detin, (e adhuronte pafundësisht atë) kur ndjeu dy duar të fuqishme ta kapnin prej beli.

- Vërtet besove se nuk do ta shijojmë natën e parë?

- Më mirë fli, se ke qenë gjatë gjithë rrugës në timon, - ia ktheu Meri që mezi e mori veten nga tronditja e befasisë.

- I lodhur, por jo deri në atë masë për të mos bërë shëtitjen tonë të preferuar!

- Po kemi ditë plot përpara. Do ta bëjmë atë shëtitje me qindra herë, - e siguroi Meri.

- Gjithçka si në fillim. Do të shijojmë si adoleshentë çdo moment, - dhe e tërhoqi pas vetes.

- Ti je i çmendur më duket!

- I çmendur pas dashurisë!

- !!! – shikimi i Merit nuk arrihej të deshifrohej se çfarë donte të kërkonte.

- Ah, më fal! Shprehje e gabuar. I çmendur pas teje!

Vetëm pas pesë minutash Meri dhe Petriti do të ishin përsëri duke ecur bregut të detit të kapur përdore si një çift adoleshentësh.

Nuk u desh shumë dhe Petriti filloi të fliste për vlerësimet e marra gjatë emërimit si kryetar dhe

projektet e reja që duheshin zbatuar në prag të fushatës tjetër.

- Një mandat i dytë duhet fituar domosdoshmërisht, - mbylli në fund ligjërimin e tij gjithë pasion Petriti.

- Petrit! Përsëri me problemet dhe idetë e tua për postin?

- Nuk të pëlqen që dhe në një mandat të dytë të ndihesh gruaja e kryetarit?

Meri nuk foli. U dëgjua vetëm përpëlitja e dallgëve në bregun e detit. Mos po debatojnë dhe ato?

Patjetër! Nuk kanë se si të rrinë pasive pas këtyre fjalëve. Por zhurma e tyre nanuritëse mori me vete dhe Merin. Brenda vetes ziente kryengritja. “Ç’po ndodhte me të shoqin? Ku shkuan parimet dhe morali që e shoqëronin gjatë fushatës? Fliste vetëm për pozitën, ndërkohë motoja se *‘Të drejtosh nuk është pozitë, por veprim’* kushedi ku qe struktur. Sa keq! Gjithçka ka ndryshuar te Petriti!”

- Ke të drejtë! – theu heshtjen Petriti. – S’duhej të hapja këtë bisedë. Ideja ishte për diçka tjetër.

Buzët e tij kërkuan të gjenin te Meri zjarrin, i cili i nevojitej në këto çaste. E tërhoqi më pranë dhe u përpoq të merrte nga ajo të njëjtën ngrohtësi. I pakënaqur nga përgjigjja e puthjes u tërhoq dhe nuk foli.

- Nuk e kuptoj se çfarë të ka ndryshuar kaq shumë, Petrit. Çdo ditë kërkuj të gjej te ti Petritin zemërbardhë pas të cilit u dashurova marrëzisht.

- *“Ndryshimi është ligj i jetës!”* – ka thënë Kennedy.

- Po, po. Ndryshimi për mirë dhe jo në këtë mënyrë, ku egoja ka gëlltitur çdo gjë të mirë e të pastër brenda teje.

- Nuk mendojnë të gjithë kështu! – ia ktheu ftohtë Petriti.

- Ah të tjerët! Më vjen keq se nuk mund të shohësh hipokrizinë me të cilën të kanë mbështjellë. I bën pyetje vetes sa do të të donin “këta të tjerët”, në qoftë se ti do të ishe në prag të humnerës? Do të të jepnin dorën apo do të të shtynin më tej?

- Mjaft! – nuk duroi më Petriti. - Leksionet lëri për nxënësit e tu të dashur!

- Po, ke të drejtë! Leksionet duhet t’i ruaj për në shkollë. Por më vjen keq se je ti vetë që në çdo çast flet vetëm për karrierën tënde. Asgjë nuk sheh tjetër përveç karriges ku je ulur, - nervozizmi në zërin e Merit i ruhej nanurisjes së dallgëve, heshtjes së yjeve dhe asaj që ishte dëshmitare e përhershme në çdo ngjarje që ndodhte në të. Natës.

- U bë vonë. Kthehemi se mos është zgjuar djali, - mezi u dëgjua zëri i Petritit. “Më mirë të kisha fjetur!” – i pohoi pa zë vetes.

\* \* \*

Asgjë nuk po shkonte siç shpresonte Meri. Pushimet aq të dëshiruara për të ndenjtur si një familje, nuk po plotësonin atë boshllëk të krijuar prej disa kohësh. Pas dy-tri ditësh Petriti filloi të gjente kohën



për të dalë dhe me shokë. Si duket nuk qenë të vetmit të ardhur për pushime këtu.

Meri atë pasdite po shëtiste djalin bregut të detit. Detin e adhuronte në çdo çast kur e shihte; në mëngjes herët ai ishte i çiltër maksimalisht, në drekë të mashtronte me ngrohtësinë e tij dhe në mbrëmje përpiqej të merrte fytyrën e të pafajshmit.

Zilja e telefonit e shkëputi nga meditari. Ishte Moza, por në ekran njëkohësisht vuri re zarfin e mesazheve. Foli shpejt me të dhe nxitoi të lexonte mesazhin. Megjithëse ankthi i tyre ishte shuar me kohë, përsëri vesi për t'i lexuar sa më shpejt ato e bënte t'i hapte mesazhet e të mos i anashkalonte me mendimin se mund të ishin ofertat e kompanisë.

“Të intereson e vërteta? Shko në hot. “D”, (hot. i fundit i shëtiti.) në dhom. 35, kati 6. Zoti është i madh prof.”

U dridh. E mbante fare mirë mend këtë shprehjen e fundit. Ç'donte t'i thoshte? A duhej t'i besonte një njeriu që donte të hakmerrej në një mënyrë aq poshtëruese? Po sikur të qe kurth?

Kaluan disa minuta dhe ende nuk po vendoste se çfarë duhej të bënte. Zemra filloi t'i rrihte fort. Në mendje i erdhi papritur shprehja e mirënjohur: “Më mirë një e vërtetë sido qoftë ajo dhe e hidhur, se qindra gënjeshtër të bukura!”

U ngrit. Mori djalin dhe u nis drejt shëtitores duke kërkuar për emrin e hotelit. Nxitoi! Ankesat e djalit,

që po vraponte për të ecur me hapin e saj, nuk frenonin ritmin e fituar. Uronte me vete të mos ishte ndonjë gjë e keqe. Analizonte ndërkohë të gjithë bisedën e fundit me njeriun e telefonatave.

Nga larg dëgjoi sirenën e ambulancës dhe pa kuptuar u gjend pranë një grumbulli njerëzish që më shumë pëshpëritnin me njëri-tjetrin. Hapën rrugën për t'u afruar dy infermierë me barelë dhe vetëm në ato çaste pa të shtrirë përtokë një vajzë, me flokë të verdhë dhe të mbuluar me gjak.

- U hodh nga kati i katërt, - dëgjoi Meri.

- E hodhën, thuaj! – pasoi tjetri.

Ndërsa Meri nuk i ndante sytë nga vajza. U afrua më shumë. Nga brenda diçka e shtynte ta shihte këtë vajzë. Djalit ia mbështeti kokën pas vetes. E dinte se nuk duhej ta mbante djalin aty, por nuk kishte mundësi tjetër. Mesazhi e pat çoroditur krejt. Në çastin kur po te ransportonin, sytë e vajzës u takuan me ato të Merit. U hutua. Mos vallë kjo ishte... Jo, jo, s'ka mundësi. Grejsa me flokët e verdha?!... Sa e marrë! Flokëve mund t'ua ndryshosh ngjyrën dhjetë herë në ditë po të duash. O Zot!

- Grejsa?

Sytë e saj vazhdonin ta shihnin, ndërkohë infermierët e futën në ambulancë.

Meri u shkëput me vrap dhe u përpoq të afrohej më shumë.

- Grejsa! – thirri përsëri.

Mbeti aty si e ngrirë. Zhurma e ambulancës dhe njerëz që vazhdonin të komentonin ngjarjen. Ndërsa te Meri sytë e vajzës mbetën të gozhduara aty, brenda saj.

- O Zot!

- Zonjë, e njihni vajzën? - një dorë po përpiquej ta shkundte Merin.

Asnjë fjalë nga Meri.

- Mami, mami, - hajde të ikim.

- Zonjë, të lutem!

Si e përhumbur ktheu kokën. Pa një burrë civil, i cili po përpiquej të bashkëbisedonte me të.

- Na ndihmoni me hetimet në qoftë se e njihni, - dhe nxori distinktivin që tregonte se ishte punonjës i policisë.

- Mos e shqetësoni! Zonja është bashkëshortja e kryetarit të...

Meri ktheu kokën nga zotëria që po fliste në ato çaste. Kushedi se si qe shndërruar shikimi i saj, sepse zotëria e la fjalën përgjysmë.

- M'u duk si, ... Po, po jam e bindur se ajo qe, - vazhdoi Meri pa i hequr sytë nga zotëria që nuk donte ta linte të fliste.

- Atëherë mund të vini me ne të bëni dëshminë tuaj.

- Nuk mund ta merrni në pyetje, sepse..., - u përpoq përsëri zotëria, i cili deshi ta pengonte pak më parë.

- Kush ju ka autorizuar ju të kujdeseni për gruan e kryetarit? – rreptësia në zërin e Merit kërkonte dikë

për të përplasur zemërimin, por ajo u përplas mbi fytyrat e njerëzve që qëndronin ende aty, edhe pse vajza e aksidentuar që larguar me ambulancë.

Zotëria nuk që më. Nuk e morën vesh se nga u largua aq shpejt.

- Mami kam frikë. Shkojmë te babi.

- Jo, xhan! Duhet t'i ndihmojmë njerëzit që kanë nevojë, si kemi thënë?

Kur po hipte në benz për të shkuar në polici, hodhi sytë nga ndërtesa nga ku ra Grejsa. Shtangu. Emri i hotelit që i njëjti me atë të mesazhit. Dhe kati përkonte po ashtu.

U zbardh në fytyrë.

- Jeni mirë zonjë? Në qoftë se nuk ndiheni mirë mjafton të na jepni adresën dhe mund të komunikojmë më vonë. Përderisa vajza është jashtë rrezikut, gjërat do të sqarohen.

- Doni të thoni se ka shpëtuar?! – habia dhe lumturia u përziën aq shumë bashkë, sa Meri në ato çaste dukej si një fëmijë.

- Po, sapo më telefonuan. Gjithsesi, duhet të presim deri nesër për të qenë krejt të bindur, - nxitoi të sqaronte inspektori.

- Të lutem, më ço në spital. Më duhet ta shoh. Patjetër! Më duhet!

- Mami, dua babin, kam frikë, - ankesa e djalit nuk arrinte në ato çaste deri te Meri, por e tërhequra e dorës nga ai e bëri atë t'i fliste:

- Zemra ime! Si mund të kesh frikë me mamën?

Pas pesë minutash u gjendën në spital. Grejsa ishte në reanimacion, në oksigjen.

- Është rëndë? – pyeti një infermiere që sapo doli nga reanimacioni.

- Mjekët janë në konsultë. Do të bëjnë të gjitha ekzaminimet e duhura për të marrë vesh më mirë gjendjen.

- Të lutem, vetëm një çast. Jam e afërmja e vetme në këtë qytet.

Infermierja e pa me dyshim nga koka te këmbët dhe me zë të ulët thotë:

- Shpejt, se më del punë mua pastaj.

Hyn brenda ngadalë, pa i shkëputur sytë nga fytyra e vajzës së shtrirë dhe me hijen e dyshimit nëse është Grejsa. Afrohet.

- Grejsa! Më shiko. Jam unë.

Kapakët e syve mezi lëvizën. O Zot! Sa ndryshim kishte në ata sy. Por qe ajo. Qe Grejsa e ëmbël. Lotët e Merit i lagën dorën dhe Grejsa u përpoq të fliste:

- Më fal! Më f..!

- Do të bëhesh mirë! Nuk kam për çfarë të të fal!

- Zonjë, duhet të dilni shpejt, ju lutem!

Sytë e Grejsës përpiqen ta shoqërojnë, por e lënë rrugën përgjysmë. Mbyllen. Nuk e di nëse do të mundet t'i hapë përsëri. Nuk do të donte t'i hapte më. Jo!

Meri tërheq këmbët zvarrë. Në oborrin para spitalit sheh të birin që vrapon drejt saj, fshin lotët dhe e përqafton duke i thënë “Shpirt i mamit, zemra ime, jeta...”

Rrugës për në hotel i tregoi punonjësit të policisë gjithçka për Grejsën.

U kthye në hotel e sflitur. Në dhomë gjeti Petritin. U ngrit i shqetësuar kur pa Merin në atë gjendje.

- E mban mend kur të kam treguar për Grejsën? Të kujtohet?

- Po, po, - nxitoi Petriti.

- Sot e pashë, por...

- Babi ne shkuam me makinën e policisë te spitali, - tha befasi djali pa e lënë Merin të mbaronte fjalën.

- Djali im me makinën e policisë në spital?! Meri, e kupton çfarë ke bërë?!...

Meri kujtohet për diçka dhe me fjalët zvarrë e pyet:

- Po ti ku ishte Petrit? Përjetova një tmerr.

- Të thashë se do të bëja një dorë bilardo me ca shokë!

U ul pa pasur fuqi të fliste më tej.

- Meri, çfarë ke?

- Grejsa! – kaq arriti të thoshte.

- Kush është Grejsa?

- Nuk e mban mend? Në qytet u fol aq shumë për të, pasi u largua pa ditur askush gjë! Pastaj ka qenë nxënësja ime! – Meri fliste, ndërkohë i ndiente duart e këmbët të këputura.

- Çfarë ka kjo Grejsa?! – pyeti jo pa interes Petriti.

- E gjeta në gjendje të rëndë sot para hotel “D”.

- Po andej ç’deshe? – nervozizmi i Petritit u shoqërua me lëvizjen e dorës.

Meri u kthye ta shihte më mirë.

- Përse është e ndaluar të shkosh andej? Ç'e bën të ndaluar atë? Pastaj...

U kujtua për mesazhin e ardhur, por vendosi të heshtte. Duhej të mendohej mirë se përse i pati ardhur ai mesazh, pikërisht për hotelin ku ndodhi aksidenti.

- Babi, te spitali ne shkuam me një xhaxhi.

- Me një xhaxhi?! – ndërkohë sytë e tij kërkonin diçka më shumë nga Meri. Asgjë nuk po kuptonte.

- Shkova të bindesha nëse ishte me të vërtetë Grejsa, dhe në ç'gjendje ishte.

- Dhe?!

- Besoj se do të shpëtojë. E rëndësishme është jeta.

Petriti priste Merin të tregonte më shumë dhe në anën tjetër Meri mezi fliste.

- Nesër në mëngjes herët do të shkoj në spital. Duhet të ndiejë dikë pranë.

- Po pushimet tona? Ti që i dëshiroje aq fort! Mos duhet t'i kalosh përsëri me nxënëset e tua që mund të jenë shndërruar në pros..., - dhe nuk vazhdoi më tutje. Fjalën ia preu Meri.

- Nuk më intereson nëse ka gabuar! E kuptove? E quaj pjesë të fajit tim nëse nuk kam arritur ta ndihmoj më parë! Tani, do ta ndihmoj sa të mundem.

- Dhe mbi kurrizin tonë?! - foli Petriti duke treguar djalin me dorë.

- Me të vërtetë Petrit nuk po të njoh më! Ç'po ndodh me ty?

- Me mua! S'mund të ndodhë kurrëgjë! Ti vazhdo të krijosh shkaqe konfliktesh! – dhe doli duke përplasur me forcë derën.

Meri nuk zbriti për të ngrënë poshtë. Djali hapi laptopin dhe filloi të luante në heshtje.

Në mendjen e saj ndërtoi disa herë situatën dhe nuk po arrinte të bindej për atë çka kishte ndodhur. Labirint mbetej mesazhi i ardhur. Mesazh nga i njëjti person. Ai vazhdonte të hakmerrej? Me kë? Përse pikërisht ajo mes atyre mesazheve? Çfarë s'po kuptonte në të gjithë këtë histori?

Petrity u kthye vonë. Dukej tepër i nervozuar. Kur pa Merin ende zgjuar e pyeti për bisedën me punonjës të policisë.

- Çfarë i the atij tjetër?

- I tregova ç'dija për Grejsën. Pastaj, nga të erdhi ky shqetësim?

- Shqetësohem për faktin se nuk di se me ç'person ka folur ime shoqe, - foli prerë ai.

- Atëherë rri i qetë, se dhe pse qe i veshur civil, bisedova me një punonjës policie pasi pashë distinktivin. Është detyrë e imja si qytetare të dëshmoj dhe të them ato çfarë pashë kur u ndodha në vendin e ngjarjes.

- E çfarë pe?

Meri u kthye me dyshim nga Petrity.

- Përse kujtohesh tani të pyesësh se çfarë pashë? Pastaj, përse duhet të të interesojë kaq shumë, pasi e di se nuk të pëlqen të hapet dy herë e njëjta bisedë brenda ditës.



- Mirë, mirë, fli... Çfarëdo të kesh parë, kuptoj se paska ndikuar për keq.

\* \* \*

Biseda në telefon vonë me Ladin e turbulloi tërësisht Petritin. Të gjitha ato parandjenja kur e pyeste Merin u shfaqën si një dokumentar. Gjithçka qe e vërtetë. Dyshoi në shikimin e asaj vajze, por as mendoi se “këto dhurata” të bëra qenë prostituta. E ç’ndryshim kishte?! Tradhtia mbetej tradhti dhe morali, moral. Pati përçafuar aq shumë tradhtinë duke flakur tej moralin!... A do të mundej të rikthente atë qetësi për t’u ndier mirë para Merit pasi të merrej vesh e gjitha kjo? O zot! Meri nuk do t’ia falte kurrë!

Morali! Qe zbehur aq shumë pasi e flaku tutje, sa tani nuk shihte asnjë lloj nuance. I shkelur me këmbë qe përçudnuar sa frika për t’iu afruar e mbushi djersë të ftohta.

Tani ndoshta qe shumë vonë për të gjykuar veten. (Se mos ishte hera e parë që e bënte një gjë të tillë!) Por këtë radhë gjërat ndryshonin! Një vajzë ndodhej në spital pasi tentuan ta vrisnin. (Nga biseda me Ladin kuptoi se ai jo vetëm qe përpjekur për ta vrarë, por po planifikonte përsëri një gjë të tillë). Duhej të bënte diçka. Nuk mund të shkonte më tej. S’mund të bëhej bashkëpunëtor në një krim. Po çfarë?!

U zhvesh. Edhe pse nuk pati veshur rrobat e plazhit, vendosi të futej në det. Errësira qe bërë aleate me të.

Ajo po e ndihmonte për të mos e marrë për të çmendur. I ftohti i ujit, dhe pse qe gusht, i shpoi trupin me qindra gjilpëra. “Vazhdo të lahesh kryetar. Po mëkatet nuk mund të lahen! Nuk e dije këtë?! Vazhdo...” Ky zë i buçiste në vesh, pa u larguar për asnjë çast. Për të shmangur këtë zë filloi të bënte not delfin sikur të qe në një garë noti, deri sa filluan t’i dhembnin krahët. Qe larguar shumë nga bregu. Vendosi të kthehej. “Duhej të bënte një kthim të tillë dhe në jetën e tij. A do të mundej?!”

Zaimi! Ky emër qëndroi gjatë gjithë kohës ulur në mendjen e tij. Duhej të bisedonte me të. Nuk mund të priste të zbardhte, ndaj ashtu i lagur i dha një mesazh të shkurtër në telefon. Gjithçka qe e qartë.

\* \* \*

Para derës së reanimacionit qëndronte një polic në këmbë. Sapo e pa Merin, përshëndeti me kokë lehtë dhe e la të hynte brenda.

- Grejsa! Jam unë xhan! Mos u shqetëso! Gjithçka do të bëhet mirë, - Meri i fliste duke i ledhatuar lehtë gishtat e dorës. Një lot rrëshqiti nëpër faqet e Grejsës. Sytë i mbante mbyllur. Meri ia fshiu lotin dhe ndërkohë vazhdonte:

- Do të shërohesh shumë shpejt. Gjithçka do të jetë si më parë.

- Jo, jo, - arriti të dëgjonte me vështirësi Meri.

Zonjë, tani duhet të dilni. Pacientes i nevojitet qetësi absolute, - infermierja me shiringë në dorë u drejtua nga Grejsa, ndërsa Meri nxitoi të dilte. Biseda me Grejsën e tronditi dhe më shumë. O zot! Nuk mund ta shihte në atë gjendje.

- Do të bëhet mirë! Duhet vetëm durim, - ishte përpjekur Petriti të qetësonte Merin.

Çdo ditë kur ngjitej në spital Meri shihte ndryshimet e Grejsës. Ajo po e merrte veten dalëngadalë dhe, para se pushimeve të Merit t'u vinte fundi, vendosi të lajmëronte nënën e vajzës. Tani Grejsa mund të fliste, por i duhej të vazhdonte të qëndronte akoma në spital. Prania e policëve i jepte siguri, por frika e shoqëronte në çdo moment.

- Grejsa duhet të flasësh! Nuk mund t'i lësh të lirë ata që të katandisën në këtë gjendje! Nuk duhet! – përpjekja e Merit për ta bindur, vazhdonte çdo ditë. I bënte përshtypje heshtja e saj. Grejsa zhytej në këtë heshtje dhe i mungonte çdo dëshirë për ta lënë pas atë. “E gjora vajzë! Kushedi ç'ka hequr”. Në kohën kur Meri do të largohej, një zë i dalë nga një hon i thellë filloi të fliste.

- Kam frikë. Shumë frikë. Ata do t'i bëjnë keq motrës, dhe..., – por nuk arriti të vazhdonte më. Lëmshi i mbledhur në grykë i bllokoi kordat e zërit.

- Grejsa duhet të guxosh! Nuk mund të biesh përsëri pre e trafikantëve të tillë. Petriti do të të ndihmojë.

- Jo! - nxitoi Grejsa. - Të lutem! E vërteta ime është shumë e hidhur. Shumë më e hidhur nga ajo që shihet.

Ndoshta po ta dije këtë të vërtetë nuk do të kujdeseshe për mua. Nuk do të doje të më shihje më kurrë!

- Sido të jetë, hidhe pas. Ti e ke në dorë, - e përqafoi lehtë për të mos e lënduar.

U largua duke qenë e bindur se Grejsa do të gjente forcë. E ëma që nisur dhe së shpejti do të ishte pranë saj. Por në diçka ende nuk qe e bindur. Mesazhet. Përse i erdhi asaj mesazhi për atë çfarë po ndodhte? Thjesht pse Grejsa qe nxënësja e saj? E kush mund ta dinte këtë?

Jo! Mos vallë... Jo! Jo! Nuk mund të mendonte kështu!

U kujtua të shikonte telefonin ku zarfi i mesazhit qëndronte pa lëvizur në ekran. Menjëherë lexoi "Është vonë. Përsëri i rregulloi punët mirë. Duhet ta zbulosh vetë të vërtetën."

Kjo ishte e tmerrshme! Ç'kërkonte ky njeri? Mos vallë e vërteta e tij...

Jo, jo. Nuk mund të ketë lidhje asgjë me Petritin.

Të nesërmen para se të nisej mësoi diçka më shumë. Kuptoi shkakun e mëdyshjes për të vajtur në polici i shoqi.

- Petrit, duhet të të tregoj diçka.

U kthye kurioz nga ajo.

- U ndodha atje se më erdhi një mesazh. Ja lexoje vetë. Dhe tani sapo lexova mesazhin tjetër. Më duhet të kuptoj ç'po ndodh!

- Në asnjë mënyrë! - nxittoi të fliste ai, pa i lexuar ende mesazhet.

- !!! – Meri priste vazhdimin e tij.  
- Për asnjë arsye nuk dua të ngatërrosh në këto punë, - foli me ton të prerë.  
- Pse jam gruaja e kryetarit?!

- Sepse mund të jenë punë të trafikantëve dhe nuk dua të përzihemi për askurrkënd në problemet e tyre. Petriti ndiente turbullimin ta përfshinte të tërin. Dikush donte ta njoftonte Merin për tradhtitë e tij. Po kush?!

- Nuk dua të futem në probleme të tilla..., për asnjë arsye!

- E përse duhet të futesh ti? Mos vallë unë kam qenë e verbër dhe nuk i kam parë gjërat mirë? – pyetja e Merit sillej rrëmujsëm në dhomë.

Petritit po i rëndonte koka. Gjërat po merrnin dhe më shumë për keq.

E ku e gjeti ai i mallkuari atë vajzë?! E bëri ta besonte se qe dhurata më e bukur për të. Ç'dhuratë! Po tani? Dikush që e njihte mirë po përpiquej t'i hapte sytë së shoqes. Duhej të gjente një zgjidhje.

- Meri, atë vajzë unë e pashë një orë para se të vdiste, - u përpoq të fliste me zë bindës.

- Piva kafe më të dhe të dashurin e saj. Prandaj nuk dua të ngatërrohem më shumë se kaq.

- Mjaft! Përse nuk më the në fillim? Më duhej ta dija. Tani nuk mund të të besoj. Në mesazh nuk mund të më ketë ardhur numri i dhomës dhe i katit se ti po pije kafe. Pastaj... Grejsa më kërkoi falje! O zot! Unë qenkam trullosur krejt! Përse do të më

kërkonte falje? A mund të biesh ti kaq poshtë?! Ajo më la të kuptoja shumë, por unë...

- Meri, ti nuk di se çfarë po flet.

- Ke lidhje me aksidentin?

- Jo! Si mund ta mendosh këtë!

- Atëherë. Nga se ke frikë? – ngulmimi i saj po e çorodiste më tej Petritin.

- Kam frikë për ty, familjen, lumturinë tonë.

- Lumturinë!... Përderisa pi kafe me trafikantë të tillë nuk mund të mendosh për lumturi. Shqetësimi te Petriti për mesazhet që mëse normal. Gjithkush do të shqetësohej për to në një situatë të tillë. Por shqetësimi më i madh për të në këtë çast që Meri.

Në polici nuk zbuluan asgjë nga mesazhet. Ato qenë çuar në numër privat.

\* \* \*

Vetëm pas dy ditësh, Ladi vendosi të largohej nga qyteti S. Përpjekjet për të “mbaruar punë” me Grejsën në spital dështuan. Ajo ruhej në mënyrë të tillë sikur të ishte e bija e ndonjë ministri dhe jo e një gruaje, sepse nënë nuk mund t’i thuhej asaj. “Bushtra! Po guxoi e foli, e mjera ajo!”

Problemi qëndronte tjetërkund tani. Petriti! Ai kishte siguruar një mbrojtje të tillë për Grejsën sa s’mund të bëhej asgjë më. Ç’mund të thurte më tej? Me gjithë kërcënimet e bëra, Petriti nuk e mbështeti në planin e tij. “Ç’maskara! Mendoi se shpenzova për

të ashtu kot?!” Gjithsesi tani duhej të takonte Xenin. Ai do të dinte t’i rregullonte punët atje lart.

Ndërkohë ndërtoi ngjarjen disa herë në mendjen e tij.

“Menjëherë pas largimit të Petritit nga dhoma, Grejsa qe shpërftyruar. Kurrë më parë nuk kishte reaguar ashtu. Ai vetë nuk mund të kuptonte se si mund të ekzistonte një lidhje e tillë mes një mësueseje dhe nxënëses së saj. Sidomos pas kaq viteve të larguara. Kurrë nuk besonte në ndjenja të tilla. Mirënjohje, sinqeritet, besnikëri... e kushedi çfarë! Për të nuk ekzistonin.

Megjithatë e fajësoi veten që realizoi këtë kontakt. Duhej të kishte nuhatur se Grejsa do ta njihte burrin e mësueses së saj. Por ç’e do! Nga të gjitha “vajzat e tij”, ajo qe më e mira. Përpjekja për ta bindur Grejsën, qe e kotë. Gjithçka kishte një cak. I kishte dhuruar tërë ato ditë qetësie. Dhe ja shpërblimi! Nuk kishte durim më! Ajo nuk qe tjetër veçse një prostitutë, e cila duhej t’i bindej. S’mund të guxonin t’i flisnin atij në atë mënyrë! Asnjëra! Prandaj nuk hezitoi ta shtynte poshtë. Por ç’e do! Shpëtoi. Askush nuk mund të shpëtonte nga ajo lartësi. U largua nga dhoma pa u kujdesur për fshirjen e provave. Punët qenë të rregulluara aq mirë, sa nuk duhej të krijohej kjo situatë.

I poshtri! Ky qe shpërblimi për të gjitha!

Ndezi kasetofonin në maksimum. Gjithçka do të rregullohej.

Drita e celularit mbi sedilje i tregoi se duhej ta kapte shpejt atë.

Me përtesë shtypi butonin. Ku e gjetën tani, - mendoj pa parë fare numrin në ekran.

- Alo, - foli me përtesë.

- Në orën 4 te vendi. Mos komunikoj me askënd derisa të flasim bashkë, - zëri urdhërues në anën tjetër që i atij që donte. Ç'rastësi! Tamam në këto çaste kishte nevojë për të. Më tej do të vendosnin se ç'do të bënin.

- Ah, po shoku. Çao! – por sinjali tregonte se ai e kishte mbyllur më parë telefonin.

Shtoi shpejtësinë. Mendimi se zgjidhja tashmë po zbriste e qetë, i dhuroi siguri. Epo nuk mund ta linin në baltë, pasi Ladi për ta kishte qenë njëshi në organizimin e të gjitha punëve. Asnjëri nga anëtarët e grupit nuk mund t'ia zinte vendin.

Në orën katër që në vendin e takimit. Shtëpia ku takohej me Xenin që e veçuar, larg fshatit D. Shtëpi njëkatëshe, e ndërtuar vitet e fundit dhe e lyster me të bardhë. Nuk donin të binte në sy. Pemët rreth e rrotull flisnin për një shtëpi të banuar. Por sa të hyje brenda bindeshe për të kundërtën. Gjithçka tregonte për mungesën e gjallërisë së jetës. Veç një taketuke e mbushur me bishta cigaresh mbi tavolinën e vogël donte t'i kundërvijë shurdhërisë së këtij mjedisi.

Perdet e errëta, të mbyllura, plotësonin zymtësinë e fytyrës së burrit të ulur në kolltuk, i cili për asnjë çast nuk e hoqi cigaren nga dora. Kollarja e liruar dhe



pullat e këmishës së hapur bënë kontrast në atë gjysmerrësirë të pllakosur.

Në oborr, asnjë makinë. Ladi u habit kur pa Lukën brenda. Ai qe lidhja me Xenin. Në telefonatën e marrë nga Xeni, ai kishte qenë i prerë. Duhej ta takonte patjetër vetë këtu.

- Nuk mundi Xeni të vinte, - nxitoi të sqaronte Luka. – Do të telefonojë më pas, sapo të mbarojë punë.

- No problem. Shefi mbetet shef, - ia ktheu Ladi dhe u zhyt në kolltukun përballë duke vënë këmbët mbi tavolinë. – Rrugë e gjatë.

Megjithëse takimet i realizonin bashkë, Luka nuk i kishte pëlqyer kurrë. I shkurtër dhe me barkun e nxjerrë para, të jepte përshtypjen e një zyrtari burokrat. Por ai qe krejt e kundërta e asaj që tregonte. Arrinte të krijonte lidhje të tilla sa të gjente rrugëzgjdhje për çdo situatë të krijuar. Ladi arrinte të qëndronte mbi të për shkak të moshës dhe pamjes. Mund të ishte në kontakt të drejtpërdrejtë sidomos kur bëhej fjalë për çështje dashurie. Mjaftonte hapi i parë, pasi më vonë merreshin të tjerët me “të dashurat e tij”. Gjithsesi, tani urrente faktin që ndodhej në duart e Lukës. Priste që Xeni të vinte patjetër.

Zilja e telefonit e shkundi nga mendimet.

- Ndryshim plani. Të duhet të vish me Lukën në G. Në orën 9 fiks do të jem atje.

Asgjë më tepër. Megjithatë mendimi se Xeni donte ta takonte e bënte të ndihej më mirë. Pa Lukën me përçmim dhe hodhi sytë nga ora.

- A nuk është mirë të nisemi tani? Në orën 9 shefi na do atje, - iu drejtua me mospërfillje.

- Më mirë kështu! – foli duke u ngritur me përtesë Luka dhe u përpoq të rregullonte këmbishën. – Më duhet pjesa tjetër e mbrëmjes për veten time, - dhe qeshi me djallëzi.

U nisën me makinën e Ladit. Gjatë rrugës pothuajse nuk folën fare. Muzika në sfond dhe tymi i duhanit qenë të vetmit shoqërues. Nuk u desh shumë për të arritur. Vendi ku do të takoheshin qe i veçuar. Njëqind metra larg tij po punohej për ngritjen e një ndërtese të re.

- Do të ndërtohet një lokal tepër modern, - theu heshtjen Luka.

Ladi vetëm sa lëvizi kokën pa u interesuar më tej. Duke vëzhguar rrugën, shqetësimi sa vinte e po rritej. Shpati i malit përballë përgjonte në heshtje, sikur donte të kuptonte diçka nga biseda e këtyre dy burrave krejt të ndryshëm në pamje nga njëri-tjetri.

Zhurma e një makine tërhoqi shikimin e të dyve. Një djalë i kollarisur më së miri zbriti nga vendi i shoferit për t'i hapur derën një mesoburri me kapele mbi kokë. Ladi buzëqeshi. E dallooi nga kapelja. Ishte Xeni. Nxitoi këmbët për t'u përballur me situatën e krijuar. Pa e pritur të afrohej më tej Xeni, pasi shihej qartë se mezi ecte, Ladi shpejtoi t'i dilte para. Një ngërdheshje nga larg në fytyrën e tij, dhe, ndërkohë, ndjeu dy duar ta shtrëngonin rrufeshëm. Reagimi i menjëhershëm i Ladit, falë fizikut dhe forcës së tij,

solli pranë katër-pesë djem të tjerë, të cilët sapo hapën rrufeshëm dyert e makinës. Në zymtësinë e natës, e cila po zbriste ngeshëm pa pyetur për atë çfarë po ndodhte në krahët e saj, u shquan tehat e thikave. Ladi as mund të mendonte më. Qe futur si i tërbuar në mes të një rrethi, i cili sa vinte e ngushtohej. Ishte i sigurt se të gjithë i çonte në botën tjetër, por mendimi se ai, mjeshtri i mashtrimit, pati rënë pre e tij, e tërbonte më shumë. Ndjeu diçka ta cikte në grykë. Tërheqja gjithnjë e më shumë e atij teli të hollë, e detyroi të lëshonte thikën në tokë. U përpoq me të gjitha forcat ta kapte përsëri, por më kot.. Forca e ushtruar mbi tel i paralizoi krejt përpjekjet e Ladit. Ndërsa përballë tij skërmitja e dhëmbëve të Lukës:

- E sheh! Duhej ta dije më parë se kush është kapoja këtu! Vendos tjetërkush se si i zgjidh problemet. Ti ke qenë gjithnjë vetëm një mashë. Tani i pavlefshëm!

Sytë e Ladit u zmadhuan aq shumë sikur donin të largoheshin nga trupi që përpëlitej vajtueshëm, ndërsa në njërën anë djali i veshur si Xeni dhe në anën tjetër Luka, vazhdonin të shtrëngonin telin prej çeliku më me forcë. Vazhduan ta mbanin ashtu dhe për disa minuta të tjera, edhe pse qenë mëse të bindur se ai nuk mund të ngrihej më, për t'u hapur probleme me mendjemadhësinë e tij.

Luka ndihej ngadhënjimtar. Më në fund nuk do të dukej më inferior për shkak të pamjes nga shikimit mospërfillës të Ladit.

Lëreni aty! – porositi djemtë. - Nuk do të vonojë shumë dhe policia do ta mësojë cili është dhe do ta akuzojë si autorin për tentativë vrasjeje të vajzës në S. Gjithçka mbyllet këtu.

Hipi në makinën e Ladit dhe u nis. Pas pak zhurma e makinës tjetër grisi me forcë qetësinë e rreme të asaj nate.

Ndërsa në rrëzë të atij shpati mali, me sy të hapur nga tërbimi dhe tmërri i kaluar, qe shtrirë Ladi i pajetë. Nuk kuptohej se ku po shikonin ata sy, por diçka qe e qartë. Askush nuk donte të ishte pre e atij shikimi. Nuk e donte shpati i malit, nuk e donte nata e zemëruar, nuk e donin zogjtë (shokët e natës), nuk e donin as yjet atje lart.

Të gjithë shpresonin të largohej sa më parë që aty.

\* \* \*

Sa shpejt që përmbysen gjërat! Gjithçka që deri në ato çaste shkëlqente me ngjyra të argjendta, ku njeriu verbohët nga këto ngjyra dhe jeton i magjepsur, menjëherë shndërrohet në ferr të vërtetë. Asgjë nuk e lumturonte më Petritin, dhe për më tepër i duhej të shtirej. Duhej patjetër të tregonte anën e njeriut të lumtur. Po ku ta gjente këtë lumturi! Mes tij dhe Merit u ngrit një barrierë e ngurtë, e padepërtueshme, ku nuk mund të kalonte as rrezja më e vogël e lumturisë.

Meri nuk arrinte ta falte për faktin se sinqeriteti i Petritit kishte humbur diku larg, shumë larg.

Jetonin të dy mes dilemës se si do të përfundonte martesë e tyre.

Petritin ndoshta e ndihmoi fati. Një pjesë e mirë e historisë nuk u zbulua. Ladin nuk e pa më dhe kjo e bënte më të qetë. Muaj më vonë dëgjoi nga Zaimi se Ladi që gjetur i vvarë.

Me gjithë dyshimin e mbetur, njëfarë sigurie u përpoq ta mbillte në vetvete se nuk do ta kërcënonte askush. Do të bënte çmos të mos përsëriste më fajë të tilla. E rëndësishme për të do të mbetej familja.

Ndërsa Grejsa... Urrejtja e mbjellë dhe dëshira për hakmarrje qenë strukur diku fort dhe luftonte me veten që t'i shtypte e të mos ngrinin më krye.

Vazhdonte jetën duke u përpjekur të kapte ritmin e humbur. “Deti me dallgë të errëta që përpiqej të përpinte gjithçka,” - iu kujtua piktura e lemerishme e E. Mançit.

Jetoi në ato dallgë, por tani ngjyra e detit i duket më e bukur, nuancat e errëta po zhdukeshin dalëngadalë.

Atë ditë tek po e shihte e etur, detin, vendosi të hynte brenda tij.

Iu duk se i gjithi i përkiste vetëm asaj, dhe ajo nuk ngopej së përqafuari atë. Ndërsa ai e tërhiqte brenda vetes së tij, shumë larg. Ndoshta për ta çuar në bregun tjetër, ndoshta donte ta shëtiste në të gjithë sipërfaqen e tij për t'i treguar bukurinë dhe madhështinë që kurrkush nuk mund ta kishte si vetë ai.

Ndërsa dielli, ky topti lakmitar dhe hileqar po i puthte ethshëm çdo centimetër të trupit, ashtu sikundër nuk do të guxonte ta puthte askush.

Deti dhe dielli!

Të dy në këto çaste qenë të sajat, vetëm të sajat.

Vendosi të kthehej. Duhej të niste një jetë të re. Valët e detit vazhdonin ta përkëdhelnin me dashuri duke e mbështetur në vendimin e saj. Ndërkohë, dielli e puthte më me etje duke i dhënë miratimin për këtë ide të bukur.

Duhej!

\*\*\*

Eh, jeta!...Një labirint me shumë kthesa e të papritura, ku nga një herë ngatërrohesh jo vetëm për faj të të tjerëve, por dhe me këmbët e tua. I fituar është ai që gjen rrugën e daljes, qoftë dhe me vështirësi e me dhimbje.

LULËZIME CELAMI (ÇIPOLLARI)  
JETË NË KTHIM

---

Formati: 13x20 cm  
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA  
Tel: (4) 22 40 116  
Tiranë, 2012

*Kushedi! Do të mbetesh enigmë. Sepse kështu që gatuar ajo.  
Enigmatike deri në fund. Me dritën e zbehtë duket se do të  
të vërë në një gjumë të rehatshëm, por në anën tjetër, shtrin  
me qindra tentakula për të parë e dëgjuar se çfarë bëhet nën  
petkun e natës.*

*Ndërsa tani... Tani Grejsës, ngjyra transparente e hënës, i  
dukej si gjurmë e një vaji të dhimbshëm.*

**BOTIMET TOENA**

ISBN 978-99943-1-806-3



9 789994 1318063

*Çmimi në librari lekë*